
KONTRATË KONÇESIONI PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË INTEGRUARA TË FURNIZIMIT TË SETIT TË PERSONALIZUAR TË INSTRUMENTEVE KIRURGJIKALË STERILE, FURNIZIMIN ME MATERIAL MJEKËSOR STERIL NJËPËRDORIMËSH NË SALLAT KIRURGJIKALE, TRAJTIMIN E MBETJEVE ME RREZIK BIOLOGJIK DHE DEZINFETIMIN E SALLAVE KIRURGJIKALE.

NDËRMJET

**MINISTRISË SË SHËNDETËSISË SË REPUBLIKËS SË
SHQIPERISË**

DHE

SANISERVICE Sh.p.k.

10 Dhjetor 2015

PËRMBAJTJA:

TITULLI	FAQE
1. QËLLIMI	6
2. PËRKUFIZIME	6
3. HARTIMI I KONTRATËS	7
4. KUSHTE PARAPRAKE TË DEKLARUAR PËR LIDHJEN E KONTRATËS	7
5. PRAKTIKAT KORRUPTIVE, KONFLIKTI I INTERESIT DHE KONTROLLI I PROCESVERBALEVE	8
6. SHËRBIMI	8
7. ÇMIMET E KONTRATËS	9
8. RISHIKIMI I ÇMIMEVE	9
9. KLASAT E KOMPLEKSITETIT OSE INTENSITETI I NDËRHYRJES KIRURGJIKALE	10
10. FATURIMI DHE PAGESA E SHËRBIMEVE	10
11. RAPORTIME	11
12. CILËSIA E SHËRBIMIT DHE RIMBURSIMI	12
13. INVESTIMET	12
14. KOHËZGJATJA E KONTRATËS	12
15. NËNKONTRAKTIMI	12
16. GARANCIA	13
17. FORMIMI/TRAJNIMI	13
18. MENAXHIMI I IT	13
19. DETYRIMET E TJERA TË PALËVE	13
20. ORIGJINA E MATERIALEVE	14
21. KRYERJA E SHËRBIMEVE: INSTALIMI DHE KONTROLLI	14
22. REALIZIMI DHE ADMINISTRIMI I ZONAVE PERIFERIKE TË BACK -UP	16
23. MBLEDHJA DHE TRAJTIMI I MBETURINAVE BIOLOGJIKE TË RREZIKSHME TË PRODHUARA NGA SHËRBIMET OBJEKT TË KËSAJ KONTRATE.	17
24. RAPORTIMI	18

25. DETYRIMET E KONÇESIONARIT	19
26. PUNËSIMI	20
27. LEJET DHE LICENCAT	20
28. SIGURIMI I PËRGJEGJËSISË PROFESIONALE	20
29. RASTET E MOS PËRMBUSHJES NGA KONÇESIONARI	20
30. DETYRIME TË AUTORITETIT	21
31. RASTET E MOS PËRMBUSHJES NGA AUTORITETI	21
32. NDRYSHIMI I LIGJEVE DHE RREGULLOREVE	21
33. PATENTIMI DHE CERTIFIKIMI I CILËSISË	21
34. AKTIVITETE TË PALËS SË TRETË	22
35. KONFIDENCIALITETI	22
36. FORCA MADHORE	23
37. NEGOCIATAT DHE AMENDAMENTET	24
38. NDËRPRERJA	24
39. DËMSHPËRBLIMI	24
40. TRANSFERIMI I TË DREJTAVE	25
41. VONESAT NË ZBATIM - DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	25
42. LLOGARITJA E AFATEVE	26
43. ZGJIDHJA E KONTRATËS	26
44. PASOJA TË TJERA TË PËRFUNDIMIT	26
45. TRANSFERIMI I ASETEVE	27
46. PARANDALIMI I KORRUPSIONIT	27
47. PUBLICITETI	27
48. PAVLEFSHMËRIA E PJESSHME	27
49. MARRËVESHJA SI NJË E TËRË	27
50. GJUHA DHE KOPJET	28
51. LIGJI RREGULLUES DHE JURIDIKSIONI	28
52. NJOFTIMET	28

ANEKSE:

ANEKSI 1	KËRKESAT E AUTORITETIT
ANEKSI 2	OFERTA E KONÇESIONARIT
ANEKSI 3	PROJEKTI TEKNIK
ANEKSI 4	LISTA E SETEVE KIRURGJIKALE DHE KLASIFIKIMI SIPAS SHKALLES SE KOMPLEKSITETIT TE NDËRHYRJES KIRURGJIKALE
ANEKSI 5	LISTA E ASETEVE QË TRANSFEROHEN NË FAVOR TË AUTORITETIT
ANEKSI 6	KONTRATA E FINANCIMIT ME FONDIN E SIGURIMEVE TË DETYRUESHME TË KUJDESIT SHËNDETËSOR
ANEKSI 7	AKT THEMELIMI DHE STATUT I KONÇESIONARIT
ANEKSI 8	SIGURIMI I KONTRATËS
ANEKSI 9	LISTA E ÇDO INSTRUMENTI ME ÇMIMET PËRKATËSE

Kjo Kontratë konçesioni nënshkruhet më 10 Dhjetor 2015

NDËRMJET:

MINISTRISË SË SHËNDETËSISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, (në vijim referuar si "**Autoriteti**"), në cilësinë e Autoritetit, sipas nenit 13 paragrafi 2/a i Ligjit Nr. 125/2013 "*Për konçesionet dhe partneritetin publik privat*", përfaqësuar nga Z. Ilir Beqja, Ministër i Shëndetësisë, ligjërisht i autorizuar për lidhjen e kësaj Kontrate;

DHE

SANISERVICE Sh.p.k. (në vijim referuar si "**Konçesionari**"), shoqëri e së drejtës shqiptare, themeluar në përputhje me Kontratën për Bashkimin e Përkohshëm të Shoqërive "Investital L.l.c. dhe Servizi Italia S.p.A. dhe Tecnosanimed S.r.l. dhe U.Jet S.r.l.", sipas Ligjit Nr. 125/2013 "*Për konçesionet dhe partneritetin publik privat*", me seli në Autostrada Tiranë - Durrës, Km 5, Kashar, Tiranë, me NIPT L51910021C, përfaqësuar nga administratori i vetëm Z. Admir Daka, në bazë të vendimit të asamblesë së përgjithshme të ortakëve të shoqërisë datë 01 Dhjetor 2015.

DUKE QENË SE:

- A. Autoriteti, me synimin për financimin, projektimin, zbatimin dhe administrimin e shërbimeve të integruara për menaxhimin e qendrës së sterilizimit pranë QSUT-së, për ofrimin e setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterile, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh (veshjeve) në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale, ka vendosur të zhvillojë një procedurë konkurruese të hapur me negociim kontrate për dhënien me konçesion të "*Shërbimeve të integruara për menaxhimin e stacionit qendror të sterilizimit pranë QSUT-së, për ofrimin e setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterile, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh (veshjeve) në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve biologjike dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale*" (në vijim referuar si "**Procedura për Dhënien me Konçesion**").
- B. Më datë 13 Shkurt 2015, Autoriteti ka publikuar Ftesën për Ofertë me anë të së cilës fton investitorë të interesuar vendas dhe/ose të huaj të marrin pjesë në Procedurën për Dhënien me Konçesion.
- C. Më datë 4 Maj 2015, Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive "Investital L.l.c. dhe Servizi Italia S.p.A. dhe Tecnosanimed S.r.l. dhe U.Jet S.r.l." me kryesues Servizi Italia S.p.A., krijuar në bazë të Kontratës për Bashkimin e Përkohshëm të Shoqërive datë 04 Mars 2015, ka marr pjesë në Procedurën për Dhënien me Konçesion duke paraqitur një propozim në lidhje me Konçesionin.
- D. Më datë 23.06.2015, Autoriteti lajmëron Bashkimin e Përkohshëm të Shoqërive "Investital L.l.c. dhe Servizi Italia S.p.A. dhe Tecnosanimed S.r.l. dhe U.Jet S.r.l." me kryesues Servizi Italia S.p.A., se oferta e paraqitur prej tij, më datë 4 Maj 2015, në Procedurën për Dhënien me Konçesion, është pranuar.
- E. Anëtarët e Bashkimit të Përkohshëm të Shoqërive "Investital L.l.c. dhe Servizi Italia S.p.A. dhe Tecnosanimed S.r.l. dhe U.Jet S.r.l.", në përputhje me Kontratën për Bashkimin e Përkohshëm të Shoqërive, sipas Ligjit Nr. 125/2013 "*Për konçesionet dhe partneritetin publik privat*", kanë krijuar shoqërinë për qëllime të veçanta të emërtuar SaniService Sh.p.k., shoqëri e së drejtës shqiptare me seli në Autostrada Tiranë - Durrës, Km 5, Kashar, Tiranë, me NIPT L51910021C.
- F. Autoriteti dhe Konçesionari përfshihen në këtë Kontratë me qëllim për të realizuar konçesionin në përputhje me afatet dhe dispozitat e përcaktuara në këtë dokument dhe dokumentet e tjera bashkëngjitur.

ATËHERË:

Palët bien dakord si vijon:

1. QËLLIMI

- 1.1 Këto kushte të Kontratës do të zbatohen për furnizimin e Shërbimeve sipas kësaj Kontrate.
- 1.2 Ligji nr. 125/2013 “Per konçesionet dhe partneritetin publik privat” parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e koncesionit/partneritetit publik privat. Disa dispozita të Kodit Civil janë ri-shprehur në kushtet e kësaj Kontrate me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të Kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave në këtë Kontratë nuk kundërshton në asnjë mënyrë zbatimin e çdo dispozite tjetër të Kodit Civil.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit nr. 125/2013 “Per konçesionet dhe partneritetin publik privat” janë ri-shprehur në kushtet e kësaj Kontrate me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të Kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave në këtë Kontratë nuk kundërshton në asnjë mënyrë zbatimin e çdo dispozite tjetër të Ligjit nr. 125/2013 “Per konçesionet dhe partneritetin publik privat”, mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 Kushtet e kësaj Kontrate do të zbatohen deri në atë masë që të mos përjashtojnë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të Kontratës
- 1.5 Kushtet e kësaj Kontrate përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (*KVK*). Në rast se ka një konflikt KVK do të mbizotërojnë.

2 PËRKUFIZIME

- 2.1 Në këtë kontratë, përveçse kur përmbajtja kërkon ndryshe:
 - Njëjësi e përfshin shumësin dhe anashjelltas;
 - Referimi tek njëra gjini përfshin edhe gjininë tjetër dhe/ose atë neutral;
 - Referimi tek akt ligjor i kuvendit, dispozite statutoare apo instrument statutor përfshin referimin tek ai akt i Parlamentit, dispozite statutoare apo instrument statutor siç është ndryshuar apo shtuar kohe pas kohe dhe tek çdo rregullore e nxjerrë sipas tij;
 - Çdo frazë që fillon me fjalët "duke përfshirë", "përfshin", "në veçanti", "për shembull" apo të ngjashme, do të kuptohen si ilustruese dhe pa kufizim ndaj përgjithshmërisë së fjalëve të përgjithshme të lidhura;
 - Referimet tek një person përfshijnë një shoqëri, korporate dhe shoqate apo autoritet;
 - Titujt e përdorur për nenet, paragrafët, nën paragrafët, anekset dhe tabelat e përmbajtjes janë vetëm për lehtësi referimi dhe nuk do të ndikojnë interpretimin e kësaj Kontrate;
 - Referimet tek çdo kontratë ose instrument janë për atë kontratë ose instrument siç janë ndryshuar, shtuar, modifikuar ose zëvendësuar kohë pas kohe;
 - Një referim tek secili organ është:
 - Nëse ai organ zëvendësohet nga një organ tjetër, vlerësohet se i referohet asaj organizate; dhe
 - Nëse ai organ pushon së ekzistuar, vlerësohet se i referohet organit që është më afër ose që në shkallën më të lartë të hierarkisë shërben për të njëjtat qëllime ose objekte sikurse ai organ.
 - Referimet në dispozitat dhe Aneksat janë, përveç rastit kur parashikohet ndryshe, referime tek dispozitat dhe anekset e kësaj Kontrate.
- 2.2 “*QSUT*” do të thotë Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”;
- 2.3 “*Kontratë*” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoriteti dhe Konçesionarit dhe që përbëhet nga Dokumentet Standarde të Konçesionit duke përfshirë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës dhe KVK, të gjitha bashkëngjitet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentet e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.

- 2.4 “*Objekt i kontratës*” do të thotë shërbimet për ofrimin e setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterilë, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale dhe ambienteve ku do të ofrohet ky shërbim, në spitalet universitare dhe rajonale, apo dhe spitale të tjerë bashkiake të vendit.
- 2.5 “*Palët*” do të thotë nënshkruesit e kësaj Kontrate.
- 2.6 “*Përfaqësuesi i Autoritetit*” do të thotë personi/njesia e emëruar nga Autoriteti, brenda 60 dite pune nga momenti i nënshkrimit të Kontratës, që është përgjegjëse për administrimin e kontratës për Autoritetin.
- 2.7 “*Autoritet*” do të thotë Ministria e Shëndetësisë së Republikës së Shqipërisë që është pjesë e kësaj Kontrate dhe që kontraktin Shërbimet objekt i kësaj Kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të përkufizuar në ligj.
- 2.8 “*Dokumentet Standarde të Konçesionit*” do të thotë dokumentet standarde të konçesionit/partneritetit publik privat për ofrimin e shërbimeve të integruara të furnizimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterilë, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale
- 2.9 “*Konçesionar*” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj Kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Shërbimet.
- 2.10 “*Shërbime*” do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Konçesionari sipas kësaj Kontrate.
- 2.11 “*Termat e Referencës*” shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen sipas kësaj Kontrate.
- 2.12 “*Strukturat Spitalore*” do të thotë strukturat spitalore të Shërbimit Shëndetësor Kombëtar të Republikës së Shqipërisë dhe që përfshijnë spitalin “Nënë Tereza” të Tiranës dhe të gjitha spitalet e tjera universitare, rajonale, bashkiake të pranishme në territorin shqiptar sipas përcaktimeve të bëra në Ftesën për Ofertë, Projektin Teknik të Konçesionarit të paraqitur në Procedurën për Dhënie me Konçesion.
- 2.13 “*Projekti Teknik*” do të thotë projekti i paraqitur nga Konçesionari për efekt të pjesëmarrjes në Procedurën konkurruese për dhënie me Konçesion.
- 2.14 “*Raporti Përmbledhës i Shërbimeve*” do të thotë raporti i përgatitur nga Konçesionari siç përcaktohet në nenin 10 të Kontratës.
- 2.15 “*PAY x USE*” do të thotë pagese unike për të gjitha shërbimet e kryera, bazuar në çdo nderhyrje kirurgjikale të kryer.

3 HARTIMI I KONTRATËS

- 3.1 Ligji nr. 125/2013 “*Për konçesionet dhe partneritetin publik privat*” dhe Dokumentet Standarde të Konçesionit, Njoftimi për Finuesin, kanë shërbyer si bazë për hartimin e kësaj Kontrate e cila është nënshkruar midis palëve brenda afatit të përcaktuar në Dokumentet Standarde të Konçesionit “**DSK**”.
- 3.2 Kontrata është e konfirmuar me nënshkrimin e saj duke përcaktuar me të, të gjitha marrëveshjet midis Palëve.

4. KUSHTE PARAPRAKE TË DEKLARUARA PËR LIDHJEN E KONTRATËS

4.1 KONÇESIONARI DEKLARON QË:

- a) Ka bërë dhe do të bëjë vlerësimet e tij për të gjitha çështjet përkatëse për zbatimin dhe përmbushjen e detyrimeve të tij bazuar në këtë Kontratë, duke përfshirë kërkimin e çdo informacioni të nevojshëm nga Autoriteti në kushtet kur Konçesionari e kërkon për një qëllim të tillë.

- b) Është në dijeni të plotë për sa i përket përmbajtjes dhe kërkesave të Autoritetit të përcaktuar në aneksin 1 (Kërkesat e Autoritetit) dhe aneksin 2 (Oferta e Konçesionarit).
- c) Ka të gjithë informacionin, pajisjet, sistemet dhe personelin e nevojshëm dhe të kualifikuar me qëllim zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga kjo Kontratë.
- d) Shoqëria Konkacionare është organizuar rregullisht dhe ekziston ligjërisht si shoqëri e themeluar sipas legjislacionit shqiptar; ka fuqinë dhe autoritetin e plotë për të ekzekutuar, realizuar dhe përmbushur detyrimet sipas Kontratës dhe për të kryer transaksionet e parashikuara në të;

4.2 AUTORITETI DEKLARON QË:

- a) Të gjitha të dhënat e vëna në dispozicion të Konçesionarit duke përfshirë dhe Dokumentet Standarde të Konçesionit, janë të sakta, të vërteta dhe pa gabime.
- b) Kjo Kontratë është nënshkruar rregullisht, nga Autoriteti, i cili gëzon të gjitha të drejtat dhe kompetencat në bazë të legjislacionit Shqiptar në fuqi dhe ka fuqinë dhe autoritetin e plotë për të ekzekutuar, realizuar dhe përmbushur detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate. Kjo Kontratë përbën detyrimin e tij ligjor, të vlefshëm dhe ligjërisht detyrues që parashikohet në përputhje me kushtet e saj.
- c) Nënshkrimi dhe zbatimi i kësaj Kontrate i nënshtrohet ligjeve në fuqi të Republikës së Shqipërisë.
- d) Pasuritë/Asetet që lidhen me zbatimin e Kontratës dhe që janë në pronësi të Autoritetit janë dhe do të mbeten të lira nga të drejtat e palëve të treta, gjatë të gjithë Periudhës së kohëzgjatjes së kësaj Kontrate.
- e) Do të mbrojtë dhe nuk do të dëmtojë Konçesionarin nga të gjitha pretendimet e palëve të treta në lidhje me përdorimin e qetë të vendeve dhe aseteve, siç parashikohet në këtë Kontratë.
- f) Nënshkrimi, realizimi dhe përmbushja e kësaj Kontrate nuk krijon konflikte, nuk rezultojnë në shkelje dhe nuk përbën kundërvajtje apo përshpejton realizimin që kërkohet nga çfarëdo kushti i ligjeve në fuqi apo Kontratave, konventave, dekretive apo urdhrave tek të cilat ai është palë apo nga të cilat ai ose cilado prone apo aset mund të ndikohen ose mbartin detyrim.
- g) Asnjë urdhër, rregull/rregullore, urdhër ekzekutimi, vendime, pezullim ose urdhër kufizues me karakter administrativ nuk do të zbatohet ose urdhërohet të zbatohet nga ndonjë organ pushteti administrativ ose Ent Shtetëror që ka juridiksionin mbi çështjen që kufizon, ndalon ose deklaron të paligjshme aktivitetet e kryera sipas kësaj Kontrate, kur këto aktivitete janë në përputhje me Ligjin dhe me rregullat e përcaktuara në këtë Kontratë.

5. PRAKTIKAT KORRUPTIVE, KONFLIKTI I INTERESIT DHE KONTROLLI I PROCESVERBALEVE

- 5.1 Autoriteti mund të kërkojë të deklarohet e paligjshme Kontrata nëse zbulon se Konçesionari ka kryer Veprime Korruptive. Me "Veprimet korruptive" do të nënkuptohen veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "*Per Prokurimin Publik*" i ndryshuar.
- 5.2 Konçesionari nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose Ent që ka marrë pjesë në përgatitjen e Dokumenteve Standarde të Konçesionit.
- 5.3 Konçesionari duhet të lejojë Autoritetin të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e Kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti.

6. SHËRBIMI

- 6.1 Kjo Kontratë ka si objekt shërbimet për ofrimin e setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterilë, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik që vijnë nga

shërbimet objekt i kësaj Kontrate dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale dhe ambienteve ku do të ofrohet ky shërbim, në spitalet universitare, rajonale dhe bashkiake të vendit, në Republikën e Shqipërisë.

- 6.2 Të gjitha Shërbimet objekt i kësaj Kontrate konçesioni duhet të kryhen në mënyrë të integruar duke sjellë në këtë mënyrë, siguri, standarde, cilësi, kosto të ulët dhe efektivitet.
- 6.3 Shërbimet, të ndërlidhura në njësi sintheze, në bazë të aktiviteteve të dhëna me konçesion sipas kësaj Kontrate, janë të përshkruara me detaje në Projektin Teknik të Konçesionarit, i cili bashkëlidhet si Aneksi 3 dhe përbën pjesë integrale të kësaj Kontrate.
- 6.4 Shërbimet do të kryen në përputhje me Kërkesat e Autoritetit siç parashikohet në Aneksin 1 (Kërkesat e Autoritetit) dhe siç ato mund të ndryshojnë gjatë periudhës së kohëzgjatjes së kësaj Kontrate konçesionare, sipas parashikimeve të kësaj Kontratë.
- 6.5 Konçesionari do të kryejë detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate në përputhje me:
- praktikat e industrisë së përparuar;
 - standardet e cilësisë të parashikuara në Bashkimin Evropian, në përputhje me kërkesat e DSK, sipas specifikimeve teknike parashikuara në shtojcën 12 të DSK
 - procedurat dhe praktikat e vendosura nga ana e vetë Konçesionarit;
 - udhëzimet e arsyeshme të dhëna nga Autoriteti gjatë periudhës konçesionare në masën që këto udhëzime lidhen apo përkojnë me Shërbimet dhe janë në përputhje me këtë Kontratë; dhe
 - nivelin e aftësive profesionale, kujdesit, planifikimit, mbikëqyrjes, kontrollit dhe gjykimit të cilat mund të priten nga një shoqëri profesioniste me përvojë në dhënie Shërbimeve sipas kësaj Kontrate.
- 6.6 Konçesionari do të sigurojë që Shërbimet do të integrohen me sistemin e shërbimeve të tjera mjekësore të ofruara nga Autoriteti në masën që është e nevojshme për të siguruar kryerjen e Shërbimeve.

7. ÇMIMET E KONTRATËS

- 7.1 Kontrata bazohet në çmimet për njësi, gjithëpërfshirës, sipas ofertës së paraqitur nga Konçesionari në Procedurën për Dhënie me Konçesion dhe pranuar nga Autoriteti, si në vijim:
- Leke 37.700 (tridhjetëeshtatë mijë shtatëqind) për ndërhyrje me kompleksitet të lartë, siç përcaktohet në nenin 9 të Kontratës.
 - Leke 22.300 (njëzetëedymijë tetaqind) për ndërhyrje me kompleksitet të mesëm, siç përcaktohet në nenin 9 të Kontratës.
 - Leke 13.900 (trambëdhjetë mijë nëntëqind) për ndërhyrje me kompleksitet të ulët, siç përcaktohet në nenin 9 të Kontratës.
 - Leke 266 (dyqindëegjashtëdhjetëegjashtë) për çdo paketim që mban instrumentet dhe/ose materialet mjekësore ambulatoriale të sterilizuara me autoklavë me avull.
 - Leke 1.090 (njëmijë nëntëdhjetë) për çdo paketim me material të sterilizuar me cikël me temperaturë të ulët.
- (në vijim referuar si "**Çmimet**").
- 7.2 Çmimet do të jenë Çmime neto, pa TVSH (Tatim mbi Vlerën e Shtuar) dhe do të paguhet sipas formulës "Pay x Use". Fatura e lëshuar nga Konçesionari do të jetë faturë tatimore me TVSH të llogaritur mbi çmimin neto.

8. RISHIKIMI I ÇMIMEVE

- 8.1 Duke konsideruar periudhën e kohëzgjatjes së kësaj Kontrate konçesioni, Palët bien dakord që Çmimet do të jenë objekt i rishikimit vjetor ("**Rishikimi i Çmimeve**") në raport me normen vjetore të indeksimit të çmimeve (inflacionit vjetor të matur), të publikuar nga Instituti i Statistikave të Republikës së Shqipërisë dhe që zbatohet në mënyrë automatike me datën 1 Mars të çdo viti, në përputhje me normen vjetore të inflacionit të vitit të mëparshëm.

9. KLASAT E KOMPLEKSITETIT OSE INTENSITETI I NDËRHYRJES KIRURGIKALE.

- 9.1 Klasat e Kompleksitetit të ndërhyrjeve kirurgjikale përcaktohen nga një seri faktorësh si për shembull por pa u kufizuar me to: i) tipologjia e instrumenteve kirurgjikal; ii) numri i instrumenteve që përbejnë setin kirurgjikal dhe numri i seteve kirurgjikale të nevojshëm për një ndërhyrje kirurgjikale; iii) materiali njëpërdorimesh për çdo ndërhyrje kirurgjikale. (ne vijim referuar si *“Klasat e kompleksitetit”*)
- 9.2 Palët bien dakord për klasifikimin e ndërhyrjeve kirurgjikale që përfshihen në Shërbimet objekt të kësaj Kontrate ne tre Klasa Kompleksiteti sipas faktorëve të përcaktuar ne nenin 9.1 me lartë. Palët bien dakord se Klasat e Kompleksitetit janë:
- i) Kompleksitet i larte;
 - ii) Kompleksitet i mesëm; dhe
 - iii) Kompleksitet i ulët.
- 9.3 Për përcaktimin dhe identifikimin e Klasës së Kompleksitetit të ndërhyrjeve kirurgjikale (Kompleksitet i larte, Kompleksitet i mesëm; Kompleksitet i ulët), Palët bien dakord t'i referohen klasifikimit të përcaktuar ne Aneksi 4 “Lista e seteve kirurgjikale dhe klasifikimi sipas shkallës së kompleksitetit të ndërhyrjes kirurgjikale”, e cila është pjesë integrale e Kontratës.
- 9.4 Palët bien dakord gjithashtu se kriteret për vlerësimin e numrit dhe tipologjisë së seteve kirurgjikale dhe materialit njëpërdorimesh të nevojshëm dhe të mjaftueshëm për të kryer tipologjitë kryesore të ndërhyrjeve kirurgjikale të listuar ne Aneksin 4, do të përcaktohen gjatë periudhës pas nënshkrimit të Kontratës dhe para fillimit të ekzekutimit të Shërbimit nga Konçisionari, pa ndryshuar Çmimet dhe Klasat e Kompleksitetit sipas Kontratës. Për vlerësimet e mësipërme do të behet referim në treguesit teknik dhe operativ të shprehur në Projektin Teknik të Konçisionarit.
- 9.5 Palët përcaktojnë se Klasat e Kompleksitetit sipas kësaj Kontrate mund të jenë objekt diskutimi, ndryshimi apo integrimi të mëtejshëm, nëse do të ndryshonin protokollat kirurgjike dhe/ose në rast të perditësimeve teknologjike që kanë efekt mbi Shërbimet. Gjithashtu, Palët bien dakord për të verifikuar çdo vit, në mënyrë periodike, nevojën për ndryshime apo integritime të Klasave të Kompleksitetit sipas kësaj Kontrate. Ndryshime apo integritime të Klasave të Kompleksitetit sipas kësaj Kontrate do të bëhen vetëm me miratim të Autoritetit, brenda muajit nëntor të çdo viti, dhe konform Projektit Teknik e Business Plan të Konçisionarit dhe ofertës së paraqitur nga Konçisionari në Procedurën për Dhënie me Konçesion dhe pranuar nga Autoriteti.

10. FATURIMI DHE PAGESA E SHËRBIMEVE

- 10.1 Shërbimet sipas kësaj Kontrate do të paguheshin sipas formulës “Pay x Use”, në baze të Raportit Përmbledhës të Shërbimeve të kryera gjatë një muaji i cili do të përgatitet nga Konçisionari dhe do të dërgohet paraprakisht Autoritetit sipërkruhet në vijim në këtë nen të Kontratës (ne vijim referuar si *“Raporti Përmbledhës i Shërbimeve”*).
- 10.2 Përcaktimi i volumeve të Shërbimeve për efekte të pagesës së Shërbimeve përfshin, në periudhën e përcaktuar, sa më poshtë vijon:
- Numrin e ndërhyrjeve kirurgjikale të kryera dhe Klasën e Kompleksitetit. Aktiviteti kirurgjikal ka të bëjë me:
- a) ndërhyrjet kirurgjikale të programuara dhe ato urgjente;
 - b) ndërhyrjet kirurgjikale në regjim të “day surgery”;
 - c) lindjet natyrore dhe me operacion;
 - d) aktivitetet invazive në ambulator ku përdoren set dhe/ose paketime me instrumente kirurgjikale, edhe instrumente kirurgjikal në kate të dimensioneve të vogla dhe/ose material tjetër sanitar dhe mjekësor, të paketuara në paketime mjekësore sterile.
 - e) numrin e materialeve të paketuara në paketime mjekësore që sterilizohet me cikël kimik me temperaturë të ulët nëse nuk mund të sterilizohet me avull.
- 10.3 Faturimi i Shërbimeve do të behet :
- i. Në baze të numrit dhe Klasës së Kompleksitetit të ndërhyrjeve të kryera në strukturat spitalore (referuar nenit 7.1(i; ii; iii).

- ii. Ne baze te numrit te paketimeve qe mbajne instrumentet dhe/ose materialet mjekësore te sterilizuara për përdorim ambulator (referuar nenit 7.1(iv).
 - iii. Ne baze te numrit te paketimeve qe mbajne instrumente dhe/ose material te sterilizuar me cikël me temperaturë te ulet (referuar nenit 7.1(v).
- 10.4 Konçesionari duhet t'i dorëzoje Autoritetit, Raportin Përmbledhës te Shërbimeve te kryera gjatë një muaji ne baze te Kontratës, brenda ditës se peste te muajit pasardhës muajit në të cilin janë kryer Shërbimet.
- Autoriteti, brenda 10 ditëve vijuese, ka te drejte te verifikojë Raportin Përmbledhës te Shërbimeve dhe brenda te njëjtit afat t'i dërgojë Konçesionarit njoftimin për pranimin ose kundërshtimin e Raportit Përmbledhës te Shërbimeve.
- Palët bien dakord që në mungesë të ndonjë njoftimi nga Autoriteti, Raporti Përmbledhës i Shërbimeve do të konsiderohet i miratuar. Në rast të ndonjë kundërshtimi të Raportit Përmbledhës të Shërbimeve siç është paraqitur nga Autoriteti brenda afatit të caktuar më sipër prej 10 ditësh, Palët angazhohen të trajtojnë dhe diskutojnë midis tyre çdo pretendim të Autoritetit dhe që ka të bëjë me Raportin Përmbledhës të Shërbimeve. Për pretendimet e verifikuara gjatë diskutimeve midis Palëve dhe pasi Palët të kenë rënë dakord për vlerat ekonomike, do të kryhet edhe rimbursimi nëpërmjet faturës më të parë që Konçesionari do të bëjë për Shërbimet e kryera gjatë ekzekutimit të kësaj Kontrate.
- Palët bien shprehimisht dakord se pavarësisht çdo pretendimi nga Autoriteti apo kundërshtimi të Raportit Përmbledhës të Shërbimeve të njoftuara nga Autoriteti, Konçesionari ka të drejtë te lëshojë faturën përmbledhëse mujore brenda datës 15 te muajit pasardhës muajit në të cilin janë kryer Shërbimet se bashku me dokumentacionin e përshtatshëm për raportimin e aktiviteteve te kryera ne periudhën përkatëse.
- 10.5 Faturat i duhen adresuar Fondit të Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor dhe dergimi i tyre mund te kryhet ne rrugë telematike dhe/ose dorazi.
- 10.6 Fatura për Shërbimet e ofruara nga Konçesionari do te paguhet brenda 30 ditëve nga data e faturës, sipas Kontratës se financimit te lidhur me Fondin e Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor, Aneksi 6.
- 10.7 Nëse Fondi i Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor nuk kryen pagesat brenda afatit sipas pershkrimit te paragrafit te mësipërm, interesat do te matarohen duke pasur parasysh normat e interesit te instrumentit kryesor te rifinancimit te Bankës Qendrore Europiane, i aplikuar ne operacionin e fundit te rifinancimit te kryer ne ditën e pare te kalendarit te semestrit përkatës, i maturuar me 7%. Norma e referimit ne fuqi ne ditën e pare te punes te Bankës Qendrore Europiane ne simestrin ne fjale aplikohet per 6 muajt e mëtejshëm. Parashikimi sipas këtij neni (10.6) nuk do te aplikohet ne rastin e pagesave te vonuara per shkak te kundërshtimit dhe /ose mosmarrëveshjeve midis Palëve.
- 10.8 Konçesionari duhet te lëshojë fatura dhe nota krediti, sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

11. RAPORTIME

- 11.1 Palët bien dakord qe Autoriteti nëpërmjet personelit qe operon në Strukturat Spitalore do të njoftojë Konçesionarin në lidhje me Shërbimet e përfituara duke i dërguar këtij të fundit një informacion ditor ("*Informacioni Ditor*"). Ky Informacion Ditor do të behet nëpërmjet plotësimit të formularëve standard që do të përcaktohen nga Palët. Struktura finale e formularëve standard për efekt të Informacionit Ditor dhe procedurat përkatëse do te përcaktohen nga Palët menjëherë pas nënshkrimit te Kontratës dhe para fillimit te ekzekutimit të Shërbimeve. Informacioni Ditor do te përfshijë, ndër te tjera, numrin identifikues, tipin e ndërhyrjes, datën, klasifikimin e ndërhyrjes dhe te konsumit te materialit integrues (paketime me avull dhe/ose me temperaturë te ulet) te kryera nga Strukturat Spitalore. Kjo e dhënë do te verifikohet nga Palet ne baze te aktiviteteve qe janë kryer efektivisht brenda cdo salle operatore.
- 11.2 Palët bien dakord qe Autoriteti nëpërmjet personelit qe operon në Strukturat Spitalore do të njoftojë Konçesionarin në lidhje me Shërbimet e përfituara per dezinfektimin e zonave kirurgjikale dhe te trajtimit dhe asgjësimit te mbetjeve te prodhuara nga aktivitetet objekt i kësaj Kontrate duke i dërguar këtij të fundit një informacion mujor ("*Informacioni Mujor*"). Struktura finale e Informacionit Mujor dhe procedurat përkatëse do te përcaktohen nga Palët menjëherë pas nënshkrimit te Kontratës dhe para fillimit te ekzekutimit të Shërbimeve, brenda 60 dite pune nga momenti i nënshkrimit te Kontratës.

12. CILËSIA E SHËRBIMIT DHE RIMBURSIMI

- 12.1 Konçesionari siguron Autoritetin qe Shërbimet do te kryhen sipas kritereve të parashikuara në dhe praktikave të kryerjes se Shërbimit, siç është e parashikuar ne Dokumentet Standarde të Koncesionit dhe Projektin Teknik te Konçesionarit.
- 12.2 Autoriteti do te garantoje Konçesionarin kundrejt çdo përdorimi te papërshtatshëm apo joefektiv te seteve kirurgjikal dhe materialeve steril një përdorimesh.

13. INVESTIMET

- 13.1 Ne baze atë asaj qe është prezantuar ne Oferte, Konçesionari impenjohet te beje këto investime ("Investimet") gjate Periudhës Kontraktore, te barabarte me 1.503.282.620,00 Lek, siç është e paraqitur ne detaj ne Aneksin 3 – Projekti Teknik.
- 13.2 Duke marre ne konsiderate variacionet e mundshme dhe variacionet e investimeve, Palët bien dakord qe ndarja e investimeve do te behet ne baze te "Tipologjisë se Teknologjisë" qe duhet konsideruar si indikative. Konçesionari do te bëjë investimet e parashikuara ne tërësi gjatë gjithë kohëzgjatjes se kësaj Kontrate ne përputhje me vlerën e përcaktuar ne paragrafin 13.1. Nëse për efekt të përmirësimit të ritmeve dhe ecurisë se zbatimit të Koncesionit do të jene të nevojshme ndryshime ne Plan Business e paraqitur nga Konçesionari dhe pjesë e Projektit Teknik, Konçesionari mund të ndryshojë vlerat e parashikuara të investimeve në vitin e parë apo të dytë apo edhe në vitet në vijim por në çdo rast pa ndryshuar totalin e parashikuar të investimit dhe në çdo rast pa ndryshuar vlerat e parashikuara të investimit për tre vitet e fundit të Koncesionit, siç janë parashikuar ne Plan Business e paraqitur nga Konçesionari dhe pjesë e Projektit Teknik.
- 13.3 Me te njëjtën mënyrë, nga momenti qe Investimet janë te lidhura direkt me fillimin e Shërbimit pranë Strukturave Spitalore (element qe nuk është i ndërlidhur me kontrollin e Konçesionarit), Investimet mund te kryhen nga Konçesionari edhe ne momente te ndryshme kohore ne krahasim me atë te përcaktuar ne *business plan-in* e paraqitur ne Oferte. Ndryshimet ne investime sipas plan biznesit, nuk prekin ri-investimet ne vitin e 6 (gjashte) dhe te 7 (shtate).
- 13.4 Riinvestime te kryera gjate Periudhes Kontraktore do te konsiderohen si arritje e vlerës totale te përcaktuar ne paragrafin 13.1.
- 13.5 Me qellim qe te behet raportimi i Investimeve te kryera, çdo vit Konçesionari do t'i paraqesë Autoritetit dokumentacionin përkatës.

14. KOHËZGJATJA E KONTRATËS

Kontrata ka kohëzgjatje 10 (dhjetë) - vjeçare, duke filluar 60 (gjashtëdhjetë) ditë pune nga data e nënshkrimit të kësaj Kontrate ("*Periudha Kontraktore*").

15. NËNKONTRAKTIMI

- 15.1 Konçesionari ka te drejtën te nënkontrakttojë nje ose me shume Shërbime ("*Nenkontraktim*") pasi te kete marre aprovimin paraprak me shkrim te Autoritetit.
- 15.2 Vlera totale e nënkontraktimit nuk mund te kaloje 40% te shumes totale te Shërbimeve te ofruara.
- 15.3 Njoftimi per aprovim i Nenkontraktimit duhet te përmbajë:
- Shërbimi qe do te nënkontraktohet;
 - Emri dhe adresa e nenkontraktorit;
 - Qëllimi dhe arsyeja e nenkontraktimit;
 - Përgjegjësia e Koncesionarit ne lidhje me perfomancen e nenkontraktorit;
 - Kohëzgjatja.

16. GARANCIA

- 16.1 Ne bazë të parashikimeve të paragrafit 3.2.1 të Dokumenteve Standarde të Konçesionit, Konçesionari ka paraqitur ofertën me një garanci të barabarte me 2% të vlerës së investimeve të përcaktuara në shtojcën 8 të Ofertës. Konçesionari ka prezantuar një garanci të barabarte me 55.200.000,00 Lek ("*Garancia e Pare*").
- 16.2 Pas dhënies me koncesion dhe siç kërkohet në paragrafin 5.5.1 të Dokumenteve Standarde të Konçesionit, Konçesionari ka zëvendësuar Garancinë e Pare me një garanci të re të barabarte me 10% të vlerës së Investimeve të përcaktuara Shtojcën 8 të Ofertës dhe të përcaktuar në Aneksin 8 të Kontratës ("*Garancia Finale*"). Garancia Finale është e barabarte me 150.400.000,00 Lek.

17. FORMIMI/TRAJNIMI

- 17.1 Konçesionari, me kërkesë dhe autorizim nga Autoriteti, dhe me një shpenzim të barabarte me leke 2.780.000,00 (ose Euro 20.000), merr përsipër të bëjë dhe të suportojë aktivitetin e trajnimit profesional të personelit spitalor mjekësor dhe infermjeristik që kryen aktivitetet në lidhje me Shërbimet e integruara në koncesion. Sesionet e trajnimit, të kërkuara nga Autoriteti ose të propozuara nga operatori koncesionar duhet të jenë të ndërlidhura me azhurnimet dhe procedurat klinike të formimit në baze të organizimit dhe menaxhimit të zonave kirurgjikale. Trajnimet mund të kryhen në vendin e punës pranë shërbimeve mjekësore të interesuara me bashkëveprimin e një tutori të kualifikuar dhe me transferta të personalit mjekësor pranë qendrave referente në Itali (modalitetet do përcaktohen rast pas rasti nga Palët).
- 17.2 Për sa i përket programeve të formimit specifik dhe procedurave dhe protokolleve që sjellin risi me Shërbimet e dhëna me koncesion, operatori koncesionar garanton aplikimin e planit formativ që do të behet me specialiste dhe teknike, në kohë dhe në mënyrë duke u bazuar në projektin teknik të garës. Fazat e formimit fillestar dhe azhurnimet e mëparshme të personelit sanitar, dhe në veçanti të personelit infermjeristik, do të programohen në akord me referentet e Autoritetit. Në rast nevojë operatorët e Koncesionarit do të jenë të disponueshëm dhe bashkëveprojnë ose të bashkëngjiten në sallën e operimit, deri tek arrija e autonomisë operative të personelit sanitar për maksimizimin e efikasitetit të Shërbimeve. Planet e formimit teknik dhe operativ do të bëhen gratis përgjatë gjithë kohëzgjatjes kontraktore, brenda kufijve të përcaktuar në paragrafin e mësipërm 17.1.

18. MENAXHIMI I IT

- 18.1 Furnizimi me sete kirurgjikale sterile mbështetet nga sistemi informatik i propozuar dhe i përshkruar në projektin teknik. Platforma IT zbatohet në baze të marrëveshjes mes Palëve në mënyrë që të sigurojë maksimizimin, efikasitetin dhe besueshmërinë e menaxhimit dhe kontrollin e proceseve produktive, për përgjueshmërinë e informacioneve, organizimin dhe monitorimin e logjistikës, për kontrollin dhe raportimin e përdorimit, për prenotimin në baze të nevojave të shërbimeve spitalore, për menaxhimin e shpërndarjes së seteve, për regjistrimin e ruajtjen e të dhënave që janë pjesë e shërbimit të integruar.
- 18.2 Teknologjitë informatike (hardware) të instaluarat pranë centralit të QSUT dhe pranë stacioneve periferike të Shërbimit dhe do të jenë konform me propozimet teknike të projektit. Do të adaptohet kriteri i perzgjedhjes, me karakteristika të njëjta funksionale, dhe me teknologji aktuale tregu, prezente në momentin e instalimit.
- 18.3 Personeli mjekësor i ndërlidhur me aktivitetet informatike të lidhura me shërbimet e dhëna në koncesion, do të trajnohet nga Konçesionari.

19. DETYRIMET E TJERA TË PALËVE

- 19.1 Autoriteti duhet të garantojë operatorëve të Koncesionarit sigurinë e përshtatshme në mjediset spitalore të dhëna në përdorim për kryerjen e Shërbimeve.
- 19.2 Në kryerjen e Shërbimeve, Konçesionari duhet të respektojë të gjitha normat ligjore në fuqi mbi sigurinë dhe higjienën në punë, përveç atyre që do nxirren gjatë periudhës kontraktore. Në rastin specifik të marrjes përsipër të menaxhimit të centralit të sterilizimit të pranishëm në QSUT, Konçesionari duhet të ketë aksesin, kontrollin dhe menaxhimin e zonave teknike të ndërlidhura me centralin që shërbejnë për prodhimin e lëngjeve (avull, ujë i trajtuar, nxehtësi etj.). Gjithashtu, Autoriteti duhet të vëri në dispozicion Koncesionarit të gjitha hapësirat e nevojshme mbështetëse dhe që kanë të bëjnë me ambientet për lëvizje, parkim, punime civile etj. Kjo vlen për të gjitha hapësirat spitalore në të gjitha spitalet, ku koncesionari do të kryejë aktivitetet e back-up, sic është parashikuar në projektin teknik.

- 19.3 Shpenzimet operative te menaxhimit te zakonshëm, te mirëmbajtjes, dhe azhurnime teknologjike do te merren përsipër nga Konçesionari. Modifikime te strukturave, te impianteve, te teknologjisë te procesit, duhen konkorduar dhe autorizuar nga Autoriteti. Konçesionari duhet te siguroje vazhdimësinë e furnizimit me energji dhe ujë te nevojshme per funksionimin korrekt te proceseve produktive. Kostot e përdorimit do te numërohen dhe do ti debitohen ne mënyrë periodike Konçesionarit nga Autoriteti.
- 19.4 Autoriteti duhet te japë ne përdorim, kur është e nevojshme per arsye logjistike, hapësira ne zonat spitalore qe mund ti lejojnë operatorit konçesionar dhe operatoreve te saj akses dhe përdorim te te gjitha strukturave te ndërtuara si magazina ose aktivitete produktive te back –up, pa u kërkuar nje qera dhe/ose rimbursim financiar. Ne këto zona operative te vena ne dispozicion nga Konçesionari dhe ne përdorim te dyfishtë, do te instalohen pajisjet e procesit siç është përcaktuar ne projektin teknik. I përkasin operatorit Konçesionar shpenzimet per furnizim, mirëmbajtje te makinerive dhe menaxhim te tyre.
- 19.5 Në qendrat e Back-up, përveç qendrës Back-up tek QSUT, Autoriteti i siguron Konçesionarit energji elektrike, uji, avull, vepra civile, impiante etj., me shpenzime në ngarkim të Autoritetit.
- 19.6 Konçesionari duhet te ketë te gjitha licencat/autorizimet e nevojshme per zhvillim e aktiviteteve specifike te lidhura me konçesionin dhe Autoriteti duhet te siguroje maksimumin e suportit Konçesionarit per marrjen ne kohe sa me te shpejte te licencave dhe dhe autorizimeve per kryerjen e rregullt te Shërbimeve.
- 19.7 Palët impenjohen ne mënyrë reciproke per ruajtjen e të mirave qe Autoriteti i ka besuar Konçesionarit dhe atyre te dhëna ne përdorim nga Konçesionari strukturave shendetesore per kompletimin e Shërbimeve. Humbjet, dëmtimet, ose prishjet e mundshme per shkak te pergjegjesise se vërtetuar te marrësit te sendeve, do te dëmshpërblehen mbi bazën e dokumentacionit tekniko ekonomik vërtetues qe pason rivendosjen e dëmit te ofruar nga pala e dëmtuar.

20. ORIGJINA E MATERIALEVE

- 20.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 20.2 Konçesionari mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 20.3 Për qëllime verifikimi, “origjinë” do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. Kemi prodhim te materiale kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 20.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

21. KRYERJA E SHËRBIMEVE: INSTALIMI DHE KONTROLI

- 21.1 Konçesionari ka detyrim të sigurojë instrumente të reja kirurgjikale, nëse Palët nuk bien dakord për të përdorur, si plotësuese, instrumentet ekzistuese në spitale. Instrumentave kirurgjikale duhet të përgatiten dhe dorëzohen te grupuara në Setin përkatës, siç përshkruhet në Projektin Teknik dhe anekset për përcaktimin e përmbajtjes te çdo Seti.
- 21.2 Përmbajtja e Setit do të përcaktohet bazuar ne ndërhyhet e ndryshme kirurgjikale, në bashkëpunim midis personelit teknik te Konçesionari dhe ekspertëve te Autoritetit. Veprimtaritë qe kane te bëjnë me personalizimin e projekt propozimeve do të zbatohen në mënyrë progresive dhe të programuar në bazë të prioriteteve të përcaktuara nga Autoriteti.
- 21.3 Kalendari, programi dhe vendi i takimeve me personelin mjeksor do të behen ne bashkepunim me Autoritetin dhe ofruesit e shërbimeve.
- 21.4 Rezultatet e çdo veprimi per personalizim te Setit do ti paraqiten Autoritetit për vlerësim dhe miratim.
- 21.5 Pas miratimit me shkrim të përmbajtjes se Setit te instrumenteve njëpërdorimshme, Konçesionari duhet të verifikojë nëse ka instrumente te tjera te përshtatshme dhe te disponueshme ne sallat operatore si dhe te siguroje instrumentet e reja per përgatitjen e Setit qe do te jepet për përdorim sipas mënyrave te parashikuara ne projektin teknik dhe sipas prioriteteve të përcaktuara nga Autoriteti.

- 21.6 "Optimizimi" i Setit si me lart duhet të behet sipas përcaktimeve ne aneksin (3) - projekti teknik te paraqitur ne Oferte "përgatitja e Setit", qe përbenë edhe dokumentin baze per tipologjitë, markën e Instrumenteve dhe përbërjen e Setit.
- 21.7 Procedurat e mësipërme do të përfundojnë brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve punë nga nënshkrimi i Kontratës në masën e nevojshme për te siguruar zbatimin e plotë të shërbimit pranë QSUT.
- 21.8 Për zbatimin e shërbimit në spitalet e tjera publike në Tiranë ose në spitalet periferike, Autoriteti mund të vendosi përdorimin e të njëjtave tipologji dhe Sete, siç janë përdorur pranë QSUT.
- 21.9 Konçesionari nuk ka detyrim te përfshijë ne përbërje te Setit pajisje elektronike, elektromekanike, pneumatike apo të tjera pajisje mjekësore që nuk janë të identifikuar qartë si instrumente kirurgjike.
- 21.10 Gjithashtu, Konçesionari nuk ka detyrim per te furnizuar te gjitha materialet kirurgjikale per konsum, materialeve prostetike ose materialeve të tjera implantet; Toolkits te specializuara dedikuar posaçërisht për materiale implantit; elektroda kirurgjikale; material ortopedik për tërheqje, stabilizator ose materiale të tjera për proteza.
- 21.11 Instrumentet dhe materialet mbuluese sterile njëpërdorimshme duhet të jenë të cilësisë së njëjtë ose me te mire, siç janë paraqitur në ofertën për pjesëmarrjen ne Garë dhe Seti i propozuar mund te ndryshohet në përbërjen e tij te propozuar në ofertën për pjesëmarrjen ne Oferte, bazuar në vlerësimet objektive dhe sugjerimet e përdoruesve te Setit.
- 21.12 Instrumentet qe janë te disponueshme ne strukturat spitalore dhe qe janë në kushte adekuate e funksionale, mund të përdoren për të kompletuar përbërjen e saktë të Setit kirurgjikal të nevojshëm për ushtrimin e ndërhyrjeve.
- 21.13 Për këtë qëllim, gjate fazës fillestare te fillimit e veprimtarisë Konçesionari duhet te beje nje inventar ne çdo sektor te kirurgjisë duke përcaktuar se cilat instrumente janë ne pronësi te Autoritetit ose ne pronësi te palëve te treta dhe qe janë ne përdorim ne sallat e operacionit apo ne qendra te tjera.
- 21.14 Karakteristikat sasiore te instrumenteve qe do te sigurohen nga Konçesionari do te jene konform standardeve te propozuara ne anekset bashkëngjitur ofertës për pjesëmarrjen ne Garë. Gjithashtu edhe për instrumentet qe nuk janë ne pronësi te Konçesionarit do te merret miratimi paraprak i personit përgjegjës të emëruar nga Autoriteti, përpara përdorimit.
- 21.15 Instrumentet e furnizuara nga Konçesionari duhet te jene te identifikueshme me ane te një shënimi me shkrim qe nuk mund te fshihet (me LASER ose te ngjashëm). Edhe instrumentet qe janë te pranishëm ne sallat kirurgjikale dhe te përshtatshme për përdorim duhet te shënohen me nje simbol te veçan identifikimi qe i bene te dallueshëm ne lidhje me instrumentet ne pronësi te Konçesionarit.
- 21.16 Instrumentet ne pronësi te Autoritetit dhe qe do te merren ne ngarkim nga Konçesionari do ti nënshtrohen te njëjtave procedura mirëmbajtjeje dhe zëvendësimi siç është parashikuar ne projekt për instrumentet ne pronësi te Konçesionarit.
- 21.17 Përmbajtja e Setit për ndërhyrjet kirurgjikale mund te ndryshohet gjate zbatimit te kësaj Kontrate, me marrëveshje me strukturat spitalore, sipas nevojave te reja qe mund te lindin gjate zbatimit te kësaj Kontrate. Çdo ndryshim i anekseve/marrëveshjeve për përbërjen e Setit duhet te merret bashkërisht midis Palëve dhe te mbahet nje procesverbal per këtë qëllim.
- 21.18 Këto ndryshime te kontratës duhet të autorizohen nga Autoriteti dhe kufiri financiar vjetor per blerjen e instrumenteve të reja dhe zëvendësimin dhe plotësimin e instrumenteve të humbur do të jetë sipas Plan Business pjese e Projektit Teknik.
- 21.19 Autoriteti do të marrë përsipër të sigurojnë që personeli i saj të ruaj dhe përdori me kujdes, instrumentet e dhënë nga Kontaktori.
- 21.20 Konçesionari do të kryejë kontrolle në inventarin e tij pranë spitaleve dhe përdorimin e duhur të materialeve. Autoriteti është i angazhuar qe personeli i saj në spital te mos beje nje përdorim te papërshtatshëm të instrumenteve apo materialeve sterile apo te mos jete neglizhent në ruajtjen e tyre, per te evituar dëme të riparueshme ose mungesa te materialeve.
- 21.21 Në rast se personeli i Autoritetit do te silltet ne mënyrë jo konforme, dhe per pasoje do te shkaktohen dëme në instrumentet e dhëna nga Konçesionari ose do te ketë shpërdorim te materialeve tej standardeve te aplikueshme Konçesionari do të zëvendësoje instrumentet e riparueshme ose që mungojnë si dhe plotësimin e materialit steril njëpërdorimesh, por mund të kërkojë rimbursim te shpenzimeve te kryera.
- 21.22 Çdo mungese ne instrumente kirurgjike dhe / ose materiale sterile duhet të njoftohet menjëherë. Ne këtë rast Palët do te procedojnë bashkërisht me konstatimin e fakteve dhe me shqyrtimin e dokumentacionit te origjinës, për të përcaktuar përgjegjësitë e tyre përkatëse.

- 21.23 Nëse do të verifikohen përgjegjësi objektive të stafit të Autoritetit, Konçesionari mund të kërkojë shpërblimin e dëmeve.
- 21.24 Konçesionari është i detyruar të kryej trajtime aktive dezinfektimi ciklik te sallave te operacionit dhe zonave përreth.
- 21.25 Në mjediset si me lart duhet të zbatohen protokolle te përditshme të eliminimit të mikrobeve me ane te dezinfektimit aktiv, sipas procedurave dhe me teknologjitë e propozuara nga Konçesionari në Projektin Teknik.
- 21.26 Te paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para fillimit të Shërbimeve sipas kësaj Kontrate, personeli i autorizuar nga Konçesionari do të kryej një inspektim të sallës se operacionit dhe në dhomat ngjitur, në çdo sërëbimit të Kirurgjisë. Gjatë inspektimit, do të përcaktohen dhe kufizohen zonat që do të dekontaminohen nga Konçesionari, nëpërmjet një komunikimi me shkrim.
- 21.27 Staf i inspektimit do të duhet ti shpjegojë Personelit Shëndetësor protokollat operative per te rene dakord ne lidhje me oraret dhe periudhën e trajtimit gjate te cilës do te kryen edhe procedurat e dezinfektimit në zona e përcaktuara.
- 21.28 Në përgjithësi aktivitetet e dezinfektimit do të kryhet çdo ditë në fund të dites, pas perfundimit te planit ditor te nderhyrjeve kirurgjikale dhe pas pastrimit rutinë. Konçesionari nuk merr persiper proceduren e pastrimit rutine ose te pastrimit te salles nga sanitaret. Dezinfektimi i sallave, mjediseve do te kryhet si hap i fundit pas te gjithave procedurave rutine te kryera nga personeli i strukturave spitalore, duke e mbyllur sallën per te qene gati per planin e nderhyrjeve te dites ne vijim.
- 21.29 Në raste të veçanta, të tilla si trajtimi kirurgjik i pacientëve të infektuar me organizma "tejet patogjene" (sëmundje tuberkulozi, HIV, Creutzfeldt Jakob, etj) mund të organizohen cikle të jashtëzakonshme dezinfektimit në kohë të ndryshme nga ato te parashikuara.
- 21.30 Ekzekutimi i trajtimit duhet të kryhet brenda rreth 15 minuta për secilin mjedis që i nënshtrohet dezinfektimit dhe po te njëjtat mjedise duhet të jene menjëherë te përdorshëm në fund të cikleve të trajtimit.
- 21.31 Procedura e dezinfektimit duhet te aplikohet ne mënyrë uniforme ne te gjithë muret perimetral te ambientit, ne dysheme dhe tavan, ne mobilje, pajisjet dhe çdo send që ndodhet ne zonat e trajtuara.
- 21.32 Për këtë qëllim, brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit te kësaj Kontrate duhet te përcaktohen me Autoritetin te gjithë formularët që do te përdoren per regjistrimin e përditshëm te çdo dezinfektimi te kryer. Dokumenti ne fjale i cili do te ruhet nga Konçesionari do te nënshkruhet nga Personeli Shëndetësor i repartit te kirurgjisë për te vërtetuar kryerjen me saktësi dhe rregullisht te procedurave te dezinfektimit nga punonjësit e Konçesionarit.
- 21.33 Produktet që do te përdoren per dezinfektim duhet te jene te certifikuar per sa i përket efikasitetit dhe nuk duhet te shkaktojnë asnjë dem për arsye te mospranueshmërisë apo toksicitetit për personat dhe/ose agresivitetit ndaj sendeve te gjendura ne sallën e operimit si dhe nuk duhet te kërkojnë ajrosjen e ambienteve pas trajtimit, sipas standarteve BE.
- 21.34 Te gjitha produktet që do te përdoren për dhënien e Shërbimit do te shoqërohen nga skeda teknike dhe e sigurisë. Produktet kimike që do te përdoren për dekontaminimin, larjen dhe dezinfektimin te instrumenteve dhe te ambienteve te sallës se operimit do ti nënshtrohen vlerësimit dhe miratimit te eksperteve përkatës te Autoritetit. Çdo ndryshim ne produktet e përdorura gjate zbatimit te kësaj Kontrate duhet te miratohet nga ekspertet përkatës te Autoritetit.
- 21.35 Punonjësit e Konçesionarit duhet te njohin dhe te ketë kualifikime te veçanta për te aplikuar protokollat përkatëse.

22. REALIZIMI DHE ADMINISTRIMI I ZONAVE PERIFERIKE TE BACK -UP.

- 22.1 Me zgjerimin progresiv te aplikimit te Shërbimeve sipas kësaj Kontrate ne te gjithë territorin duhet te realizohen te gjitha "zonat periferike te back -up" sipas mënyrave te zbatimit dhe planit kohor te përcaktuar ne projektin e paraqitur ne oferten për Koncesionin.
- 22.2 Ne veçanti, pasi Shërbimi te jete aktivizuar plotësisht ne QSUT (ose pas 180 dite nga nënshkrimi i kësaj Kontrate), brenda 180 ditëve vijuese duhet te realizohen dhe aktivizohen 4 qendra te back -up ne spitalet e tjera publike te Tiranës. Ne vijim, brenda 180 ditëve te tjera duhet te realizohen dhe aktivizohen 13 qendrat e tjera te back -up ne spitalet e tjera publike bashkiake, siç përcaktohet ne Projektin Teknik te paraqitur ne Oferten per Koncesionin.
- 22.3 Duke qene se kemi te bëjmë me aktivizimin progresiv te shërbimeve objekt te kësaj Kontrate, ne bashkëpunim me Autoritetin do te përcaktohen prioritetet e mundshme, kur shihet e nevojshme dhe ne mirekuptim mes paleve.
- 22.4 Ne çdo qendër te back -up duhet te instalohen pajisje te reja ne zëvendësim apo plotësim te autoklavëve dhe/ose makinave te larjes që ndodhen aktualisht ne strukturat spitalore. Karakteristikat e autoklavëve dhe makinave larëse duhet

te jene sipas projektit teknik te paraqitur ne Oferten per Koncesionin duke parashikuar ndryshime te mundshme te karakteristikeve te pajisjeve per tu instaluar ne varësi te nevojave efektive te cdo spitali, karakteristikeve mjedisore dhe/ose kufizimeve strukturore qe do te mund te verifikohen ne Spitale. Ndryshimet e mundshme ne tipologjine e makinerive per tu instaluar do te dakordesohen midis Palëve me marrëveshje me shkrim.

- 22.5 Zonat qe do te përdoren për këtë qëllim do te caktohen me marrëveshje me personat përgjegjës te emëruar nga Autoriteti e cila do te siguroje, nëse është e nevojshme, përshtatjen e impianteve ekzistuese për instalimin e teknologjive te reja, te cilat do te furnizohen dhe kolaudohen nga Konçesionari.
- 22.6 Çdo qendër e back -up, do te asistohet nga punonjës te Konçesionarit te cilit do te kujdesen per rikondicionimin dhe sterilizimin e instrumenteve, për administrimin e stokut te materialit njëpërdorimshme steril, per transportimin e koshave te mbetjeve te prodhuara nga Shërbimi.
- 22.7 Prania e punonjësve te Konçesionarit duhet te jetë e programuar ne te njëjtat periudha te realizimit te ndërhyrjeve kirurgjikale dhe ne raste te veçanta, per nevoja te shërbimit mund te dakordesohen nderresa gatishmërie, ne orët e natës dhe ne ditët e pushimi zyrtar dhe festave zyrtare.
- 22.8 Ne përgjithësi punonjësit e Konçesionarit duhet te jene te pranishëm nga dita e Hene deri ditën e Shtune ne varësi te orës kur zhvillohet ndërhyrja kirurgjikale, përveç rastit kur Palët kane vendosur ndryshe per shkak te veprimtarive qe kane kohëzgjatjes se nderresave, me pak apo me shume.
- 22.9 Çdo qendër back -up do te jetë e informatizuar për te siguruar zbatimin e procedurave te prenotimit sipas nevojave javore si dhe per efekt raportimi.
- 22.10 Konçesionari do te jete përgjegjës per funksionimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve te instaluar.

23. Mbledhja dhe Trajtimi i Mbeturinave Biologjike te Rrezikshme te Prodhuara nga Shërbimet Objekt te kësaj Kontrate.

- 23.1 Ne baze te mënyrave te parashikuara ne projektin teknik, punonjësit e Konçesionarit do te bëjnë mbledhjen e mbetjeve biologjike te rrezikshme te cilat janë rezultat i Shërbimeve objekt te kësaj Kontrate.
- 23.2 Ne veçanti behet fjale për materiale njeperdorimeshe dhe te ngjashme te nevojshme per mbulimin steril te pacientit dhe veshjet e personelit mjekësor, kapele, maska etj.
- 23.3 Materialet si me lart te cilat janë përdorur për te ofruar Shërbimet objekt te kësaj Kontrate mund te jene te ndotur me gjak dhe/ose lëngje organike te tjerë dhe si rrjedhim duhet te trajtohen ne baze te legjislacionit ne fuqi per trajtimin e mbetjeve spitalore.
- 23.4 Konçesionari ka detyrim qe te furnizojë kutite perkatese per mbledhjen e mbeturinave si dhe te realizojë procedura teknologjike per transportin dhe trajtimin e tyre, procedura te cilat mbështeten ne autorizimet përkatëse te dhëna nga institucionet pergjegjese.
- 23.5 Mbetjet do të vendosen në kutitë përkatëse të dhëna nga Konçesionari. Kutitë do të mbyllen nga (Autoriteti) personeli i sallës së operacionit nëpërmjet etiketave që do të vihen në dispozicion nga Konçesionari.
- 23.6 Personeli mjekësor duhet te trajtohet nga Konçesionari per zbatimin e sakte te protokolleve te dezinfektimit te mbetjeve, te ambalazhimit te kutive dhe plotësimin e formularëve dhe etiketimit qe lejon identifikimin e mbetjeve gjate fazës se depozitimit te përkohshëm dhe transportit.
- 23.7 Punonjësit e Konçesionarit duhet te tërheqin mbetjet nga “depozita e përkohshme” e cila do te vendoset ne zonën e spitalit qe do te vihet ne dispozicion nga Autoriteti.
- 23.8 Nuk do te mblidhen dhe trajtohen mbetje me risk biologjike te ndryshme nga ato qe gjenerohen si pasoje e shërbimeve te ofruara nga Konçesionari.
- 23.9 Mbetjet do te transportohen nga depozitat e përkohshme per ne qendrat e trajtimit te Konçesionarit, brenda afateve te caktuara nga ligjet ne fuqi.
- 23.10 Mbetjet do te trajtohen me teknologjinë dhe sipas protokolleve te përcaktuar ne projekt, do te tjetërsohen dhe transformohen ne jo te dëmshme per tu trajtuar si “mbetje urbane” konform legjislacionit ne fuqi.
- 23.11 Protokollat e përcaktuara per administrimin dhe trajtimin e mbetje me rrezik biologjik dhe autorizimet përkatëse duhet qe ti paraqiten paraprakisht Autoritetit, para momentit te fillimit te shërbimit.

24. RAPORTIMI

- 24.1 Shërbimet e Integruara të dhëna me konçesion, duhet të jenë të gjurmueshme. Informacionet duhet të trajtohen dhe të ruhen në mënyrë informatike dhe marrja e të dhënave nga sistemi mund të kryhet si "on line" ose edhe nëpërmjet përdorimit të formularëve specifike të përgatitur nga Konçesionari dhe të miratuara nga Autoriteti.
- 24.2 Duhet të përdoren sisteme të njohjes për lexues optikë që do të vendosen në produktet e furnizuara dhe / ose të përpunuara në centralin e sterilizimit. Duhet të përdoren etiketa ngjitëse me bar kod ose të ngjashme për lexim dhe ruajtjen e të dhënave në format elektronik.
- 24.3 Formularët në letër të përdorura për shkëmbimin e informacionit do të duhet të ketë firmën/at e personelit të caktuar për kontrollin e shërbimit, do të duhet të arkivohen me anë të procedurës me skanim dhe të ruhen për gjurmueshmërinë, për gjithë kohëzgjatjen e kontratës.
- 24.4 Në veçanti, si në furnizimin e seteve kirurgjikale dhe të materialeve sterile njëpërdorimshme, regjistrimi i përdorimit dhe konsumit do të bëhet e gjurmueshme përmes etiketave ngjitëse që do të shoqërojnë çdo produkt të furnizuar. Etiketat do të ngjiten në një formular të numëruar të përgatitur me marrëveshje ndërmjet palëve.
- 24.5 Dokumenti do të plotësohet në dy kopje nga ana e Personelit Mjekësor dhe një kopje do të kthehet në Qendrën e Shërbimit të Konçesionarit për evidentimin e të dhënave të konsumit.
- 24.6 Dokumenti duhet të parashikojë së paku: treguesin e referencës së procedurës kirurgjikale; datën e operacionit; dhe nënshkrimin e përfaqësuesit të ngarkuar apo të deleguar të Personelit mjekësor, që vërteton përdorimin.
- 24.7 Mbi bazën e rezultateve të informacioneve të përdorimit brenda pesë ditëve të para të muajit pasardhës, Konçesionari do të duhet të përgatisë një raport përmbledhës për volumin e shërbimeve të ofruara, sipas tipologjise së nderhyrjes kirurgjikale, shërbimit perkates kirurgjikal dhe salles kirurgjikale. Raporti i përdorimit do të duhet të shqyrtohen nga Autoriteti.
- 24.8 Nëse, nga krahasimi midis raportit dhe përdorimit real do të rezultojnë mospërputhje, rakordimi përkatës financiar do të bëhet në llogaritjen e likuidimit të faturimeve të mëvonshme.
- 24.9 Palët do të bihen dakord për një procedurë të ngjashme gjurmueshmërinë klinike dhe administrative, në lidhje me përdorimin e paketimeve të sterilizuara mjekësore me avull dhe/ose me temperaturë të ulët.
- 24.10 Protokollet dhe formularët do të duhet të përcaktohen brenda datës së fillimit të Shërbimit.
- 24.11 Gjatë kohëzgjatjes së konçesionit, Autoriteti ka të drejtë, të monitorojë objektin e konçesionit për periudha gjashtë mujore, për të verifikuar përmbushjen e detyrimeve sipas kësaj kontrate, në të gjitha fazat e zbatimit të saj. Ky monitorim do të kryhet nga ana e përfaqësuesve të deleguar të Autoritetit duke njoftuar paraprakisht shoqërinë Konçesionare. Megjithatë, Autoriteti mund të kryejë një monitorim të tillë në çdo kohë, nëse ka informacione të arsyeshme dhe të besueshme mbi mos përmbushjen e detyrimeve të kësaj Kontrate. Në rast të mos përmbushjes së detyrimeve nga ana e Konçesionarit, të zbuluara gjatë monitorimit, Konçesionari do të njoftohet me shkrim për masat e marra dhe detyrimet e vendosura në ngarkim të tij, si dhe për afatet e arsyeshme kohore për realizimin e tyre. Në rast se do të jetë e nevojshme, do të zbatohen edhe dënimet e specifikuar në kontratë.
- 24.12 Autoriteti mund të kryejë kontrole sa herë që do ta konsiderojë të arsyeshme për realizimin e projektit. Kontrolli do të kryhet nga strukturat e ngarkuara nga titullari i Autoritetit, duke njoftuar paraprakisht Konçesionarin.
- 24.13 Autoriteti do të bëjë çdo përpjekje të mundshme për të garantuar që kryerja e çdo kontrolli të vetëm të mos ndërpresë në mënyrë të paarsyeshme punën e Konçesionarit ose të shkaktojë vonesa në realizimin e projektit.
- 24.14 Pa prekur detyrimet për ruajtjen e konfidencialitetit të Autoritetit, Konçesionari do t'i japë Autoritetit (dhe/ose përfaqësuesve të tij) të gjithë bashkëpunimin e arsyeshëm dhe asistencën përkatëse, për çdo kontroll të vetëm, midis të cilave:
- (i) të gjitha informacionet e kërkuara nga Autoriteti në kuadrin e kontrollit të lejuar;
 - (ii) mundësinë për të hyrë në çdo zonë të kontrolluar nga ana e Konçesionarit;
 - (iii) mundësinë për të hyrë në mjediset ku realizohet kontrata; dhe
 - (iv) për qëllimet e kontrollit, Autoriteti duhet t'i komunikojë Konçesionarit objektin e kontrollit të paktën 14 ditë pune përpara.
- 24.15 Shpenzimet që do të kryhen për qëllimet e kontrollit do të jenë në ngarkim të Autoritetit;

24.16 Në rast se nga kontrolli do të zbulohet se Konçesionari nuk ka përmbushur disa prej detyrimeve të tij sipas kësaj kontrate, palët do të bien dakord dhe të zbatojë një plan korrektues. Autoriteti do të mbështesë Konçesionarin në zbatimin e planit korrektues. Në rast të moszbatimit do të zbatojë dënimet e parashikuara në këtë kontratë

25. DETYRIMET E KONÇESIONARIT

25.1 Detyrimet e Përgjithshme të Konçesionarit

Konçesionari duhet t'i kryejë Shërbimet dhe përmbushi detyrimet e tij në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale të pranuar në përgjithësi.

Konçesionari duhet të ndjekë praktika të shëndosha të biznesit dhe të përdorë teknologji të avancuar dhe të përshtatshme si dhe metoda të sigurta.

Konçesionari do të sigurojë që projekti të jetë në përputhje me:

- a. Kërkesat e Autoritetit siç përcaktohet tek Aneksi 1;
- b. Ofertën e Konçesionarit të parashikuar në Aneksin 2;
- c. Këtë Kontratë;
- d. Aneksat e parashikuara në këtë Kontratë;

Konçesionari do të zbatojë Projektin Teknik në përputhje me:

- a. Praktikën bashkëkohore në këtë fushë;
- b. Planet e Cilësisë;
- c. Nivelin e aftësive profesionale, kujdesit, planifikimit, mbikëqyrjes, kontrollit dhe gjyqimit të cilat mund të priten nga një shoqëri profesioniste me përvojë në dhënien e shërbimeve të tipit dhe kompleksitetit të kërkuar nga Autoriteti sipas kësaj Kontrate.
- d. Manualët e cilësisë, sigurisë dhe standardeve të aplikueshëm të cilat do të përgatiten nga Konçesionari brenda vitit të parë të kësaj Kontrate. Këto dokumente pasi të jenë miratuar edhe nga Autoriteti do të certifikohen (nga Konçesionari) nga institucionet apo entet e akredituara. Nëse ka një dështim në përmbushjen e një/disa detyrimeve apo nëse Konçesionari beson se do të ketë një Dështim në përmbushjen e një/disa detyrimeve, Konçesionari do të:
 - a. Njoftojë Autoritetin menjëherë për Dështimin apo Dështimin e mundshëm në përmbushjen e detyrimit;
 - b. sigurojë pranë Autoritetit një Plan Korrigjimi të afateve dhe veprimeve që ai do të ndërmarë për të ndrequr Dështimin, brenda 15 ditëve pune nga data që Konçesionari njofton Autoritetin.
 - c. vërë në përdorim të gjitha burimet shtese dhe do të ndërmarë të gjitha veprimet rregulluese që janë të nevojshme për të ndrequr apo për të parandaluar Dështimin në të ardhmen.

25.2 Detyrimet e Veçanta të Konçesionarit

Konçesionari duhet të kryejë të gjitha Shërbimet siç specifikohet tek Termat e Referencës, duke përfshirë termat e referencës për nënshkrimin e kësaj kontrate dhe ato që do të hartohen pas nënshkrimit të kontratës. Konçesionari duhet t'i paraqesë Autoritetit të gjitha shërbimet, në sasi të përcaktuara, siç kërkohen nga kontrata duke përfshirë, por jo të kufizuara nga, të gjitha raportet, dokumentet, studimet, skicimet dhe planimetritë. Konçesionari duhet të sigurojë raportet periodike të lidhura me zbatimin e Shërbimeve siç kërkohet në kontratë.

26 PUNËSIMI

- 26.1 Konçesionari do të siguroje personel të mjaftueshëm në mënyrë që të plotësojë kërkesat e përcaktuara në këtë Kontratë. Konçesionari do të bëjë përpjekje për të nxitur punësimin në zonat përreth ku shtrihet projekti.
- 26.2 Konçesionari do të bëjë përpjekjet e tij me të mira për të siguruar mbajtjen e personelit të kualifikuar në nivel administrativ dhe të siguroje që çdo zëvendësues do të jetë i kualifikuar dhe me përvojën e përshtatshme dhe tërësisht kompetent për të zbatuar detyrat e caktuara të personit të cilin ai/ajo ka zëvendësuar.
- 26.3 Konçesionari garanton se do të siguroje një numër të përshtatshëm punonjësish për çdo tipologji shërbimi duke siguruar vazhdimësi dhe kryerje të rregullt të Shërbimeve të parashikuara, gjatë gjithë kohëzgjatjes së Kontratës dhe në çdo periudhë të vitit. Në rast të ndonjë mungese Konçesionari do të marrë masa për ta zëvendësuar menjëherë. Punonjësit e Konçesionarit që ofrojnë shërbime në strukturat e Autoritetit do të kenë një sjellje shembullore dhe korrekte si në raportet me personelin shëndetësor ashtu edhe me pacientet dhe do të veprojnë në çdo rast me kujdesin më të madhe profesional.
- 26.4 Punonjësit e Konçesionarit do të jenë subjekt i kontrolleve të detyrueshme mjekësore dhe/ose vaksinimeve të kërkuara nga ligji për sigurinë në punë të aplikueshëm për personelin mjekësor. Në përgjithësi, Konçesionari duhet të sigurojë mbrojtjen e punonjësve të tij në përputhje me rregullat e higjienës, parandalimit të aksidenteve, mbrojtjes nga infektimi profesional, duke bërë pajisjen me rroba dhe strumente për mbrojtje personale. Punonjësit e Konçesionarit do të identifikohen përmes një distinktivi identifikimi dhe veshjeve dalluese. Konçesionari me fillimin e dhënies së shërbimeve duhet të njoftojë listën e punonjësve në shërbim, gjithashtu duhet të njoftojë çdo ndryshim në listë. Lidhur me organizimin dhe zbatimin e shërbimeve Konçesionari do të sigurojë trajnimin e stafit të tij në mënyrë që çdo gjë mund të kryhet në mënyrë të rregullt. Programi i trajnimit duhet të jetë konform planin të trajnimit përshkruar në projektin teknik. Kurset e trajnimit dhe perditesimit do të jene në ngarkim të Konçesionarit.

27. LEJET DHE LICENCAT

Konçesionari do të jetë përgjegjës për sigurimin e lejeve ose licencave sipas kërkesave të Ligjeve të Republikës së Shqipërisë për kryerjen e Shërbimeve në këtë Kontratë përveç rastit kur Palët bien dakord ndryshe.

28 SIGURIMI I PËRGJEGJËSISË PROFESIONALE

- 28.1 Konçesionari duhet të mbajë sigurim për përgjegjësi profesionale sipas rregullave dhe praktikave të njohura në përgjithësi për profesionin për ta zhdëmtuar Autoritetin për dëme të rezultuara nga neglizhenca, gabimet ose mangësitë, në kryerjen e Shërbimeve.
- 28.2 Nëse nuk është përcaktuar në Kontratë shuma minimale e sigurimit, Konçesionari duhet të sigurojë sigurim në shumën e njohur në përgjithësi si të mjaftueshme nën rrethanat e Shërbimeve që po sigurohen.

29. RASTET E MOS PËRMBUSHJES NGA KONÇESIONARI

Secili prej rasteve që vijon përbën rastin e mos përmbushje nga Konçesionari (Rastet e Mospërmbushjes nga Konçesionari), përveç kur Rasti i Mospërmbushjes nga Konçesionari vjen për shkak të Rastit të Forcës Madhore apo veprimeve të Autoritetit:

- (i) Konçesionari nuk ka përmbushur ndonjë prej detyrimeve të tij në afatin e duhur sipas Kontratës dhe nuk ka arritur që brenda afatit përkatës të korrigjimit të caktuar nga Autoriteti, të ndreqë këtë mospërmbushje.
- (ii) Çdo deklaram i bërë ose garanci e dhënë nga Konçesionari, sipas kësaj Kontrate zbulohet të jetë fals ose i pasaktë.
- (iii) Konçesionari ndodhet para Rastit të paaftësisë pagese.

30. DETYRIME TË AUTORITETIT

Përveçse kur është parashikuar ndryshe në këtë Kontratë, Autoriteti merr përsipër edhe detyrimet e mëposhtme:

- (i) Te sigurojë vazhdimësinë e Kontratës.
- (ii) T'i sigurojë Konçesionarit të dhëna dhe informacion të rëndësishëm për përmbushjen e detyrimeve të tij në këtë Kontratë, dhe/ose të dhëna e informacion që kërkohen për menaxhimin, operimin dhe zhvillimin e Projektit (gjithmonë nëse Autoriteti disponon këto të dhëna apo informacione), dhe të informojë Konçesionarin për çdo ngjarje në lidhje me objektin e koncesionit, dhe t'i dorëzojë Konçesionarit kopje të këtij informacioni dhe të të dhënave.
- (iii) Te përkrahë dhe asistojë Konçesionarin duke marrë të gjitha masat e nevojshme nëse ndonjë Ent Shtetëror me veprimet dhe/ose mosveprimet e tij shkakton ose mendohet që mund të shkaktojë pengesa dhe/ose ndërhyjë në zbatimin e Projektit, operim eficient të Projektit ose të përmbushjes nga Konçesionari të kushteve të kësaj Kontrate, përfshirë ushtrimin nga Konçesionari të të drejtave të transferimit të fondeve dhe pagesave pa kufizime dhe pa vonesa, në përputhje me Ligjin e Zbatueshëm.
- (iv) Te bëjë çdo përpjekje për të siguruar lidhjen e marrëveshjeve/kontratave të Konçesionarit me institucione publike për qëllime të realizimit të objektit të kësaj Kontrate.

31. RASTET E MOS PËRMBUSHJES NGA AUTORITETI

Secili nga rastet si vijojnë përbejnë rastet e mos përmbushjes së detyrimeve nga Autoriteti ("Rast i Mos përmbushjes nga Autoriteti"), përjashtuar rastet kur ky Rast Mos përmbushje nga Autoriteti, ndodh si rrjedhojë e një Rasti Mos përmbushje të Konçesionarit ose për shkak të një Rasti të Forcës Madhore:

- (i) Autoriteti apo çdo Ent Shtetëror nuk përmbush ndonjë nga detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate dhe njëkohësisht nuk e ndreq këtë mos përmbushje brenda afatit përkatës të ndreqjes të caktuar në këtë Kontratë për një rast specifik, dhe nëse nuk behet fjale për këtë rast, pas afatit të caktuar për ndreqje nga Autoriteti apo Enti Shtetëror me kusht që ky afat mos të jete më pak se 40 (dyzet) dite pune, ose
- (ii) Autoriteti nuk e njeh këtë Kontratë ose në një mënyrë tjetër të të kuptojë qëllimin e saj për të mos qene me e detyruar sipas kësaj Kontrate; ose
- (iii) Autoriteti apo çdo Ent Shtetëror, si rrjedhojë e veprimeve apo mosveprimeve të tyre si dhe atëherë kur duhet, sipas kësaj Kontrate, krijojnë rrethana të tilla që nuk lejojnë Konçesionarin të përmbushë detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate dhe nuk e ndreqin këtë mos përmbushje brenda 3 ditëve, pune pas mbarimit të periudhës së ndreqjes të lajmëruar nga Konçesionari; ose
- (iv) Autoriteti vonon pagesën e çdo shume të detyruar dhe të kërkueshme nga Konçesionari, me përjashtim të rastit kur midis Autoritetit dhe Konçesionarit kanë lindur mosmarrëveshje që kanë të bëjnë me Raportin Përmbledhës të Shërbimeve; ose
- (v) Çdo deklaram i bere ose garanci e dhënë nga Autoriteti në këtë Kontratë zbulohet që është fals, i pasaktë ose i pavërtetë.

32. NDRYSHIMI I LIGJEVE DHE RREGULLOREVE

Nëse pas datës së nënshkrimit të kësaj Kontrate, ndonjë ligj, rregullore, urdhëresë, urdhër ose procedurë me efektin e ligjit në Republikën e Shqipërisë, hyn në fuqi, nxirret ose ndryshon duke ndikuar kushtet e Kontratës përfshirë datën e dorëzimit, ose Çmimin e Kontratës, kushtet ose Çmimi i Kontratës do të rregullohen në atë masë sa Konçesionari është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas Kontratës.

33. PATENTIMI DHE CERTIFIKIMI I CILËSISË

- 33.1 Nënshkrimi i kësaj Kontrate dhe fillimi i Shërbimeve nuk transferon ndonjë certifikate patentimi nga Konçesionari ose partneret, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 45 të kësaj Kontrate.
- 33.2 Autoriteti nuk ka arsye të pretendojë të drejta, tituj ose interesa specifike mbi aktivitetet intelektuale si sistemet IT, software, patent ose të njëjta që janë pronësi e Konçesionarit, përveç të drejtës së përdorimit nga ana e Autoritetit.
- 33.3 Në çdo rast shërbimet e ofruara nga operatori koncesionar dhe çmimet relative përfshijnë dhe përdorimin nga ana e strukturave spitalore dhe programe informative të adaptuara nga Operatori Koncesionar e njëjta gjatë periudhës kontraktuale.

- 33.4 Palët angazhohen me referentet e vet të ndajnë informacione teknike dhe operative të duhura për përgatitjen e manualit të cilësisë me të cilën operatori Koncesionar do të aplikojë për certifikimin EN ISO 9001:2008 dhe konformitetin mbi bazën e normave specifike për pajisjet dhe materialet mjekësore EN ISO 13485:2012. Marrja dhe konformiteti i këtyre certifikimeve duhet bërë brenda 18 muajve të mëvonshëm nga data efektive e aktivizimit të Shërbimit.
- 33.5 Koncesionari ka detyrën për mirëmbajtjen dhe certifikimin e cilësisë duke siguruar vazhdimësinë e kushteve që duhen verifikuar me anë të vizitave periodike të mbikëqyrjes nga një "Ent Certifikues Evropian".
- 33.6 Gjate ekzekutimit Kontrata e koncesionit mund të ndryshohet në lidhje me mënyrat operative dhe/ose produktet e përdorura duke ruajtur në çdo rast standardet e cilësisë të parashikuara.

34. AKTIVITETE TE PALËS SE TRETE

- 34.1 Pas nënshkrimit të Kontratës, palët mund të vlerësojnë dhe bien dakord për mundësinë e Koncesionarit për të përdorur makineritë dhe zonat e dedikuara për shërbimin e sterilizimit pranë strukturave spitalore (si p.sh pranë Nene Terezës Tirane) për të ofruar shërbimet e sterilizimit të strukturave sanitare të ndryshme nga ato që janë pjesë e Autoritetit, vetëm nëse Autoriteti e kërkon.

35. KONFIDENCIALITETI

- 35.1 Perverse kur është e përcaktuar në këtë nen ose kur zbulimi i informacionit lejohet shprehimisht diku tjetër në këtë Kontratë, secila Pale:
- Do të trajtojë Informacionin Konfidencial të Palës tjetër si konfidencial dhe ruaje atë në mënyrën e duhur; dhe
 - Nuk do t'i zbulojë Informacionin Konfidencial të Palës tjetër asnjë personi pa miratimin paraprak me shkrim të zotëruesit.
- 35.2 Dispozita e mësipërme nuk do të zbatohet nëse:
- Ky informacion ka qenë në zotërim të Palës që bën zbulimin pa detyrimin e konfidencialitetit para zbulimit të tij nga zotëruesi i informacionit;
 - Ky informacion ishte përfutur nga një pale e treta pa detyrimin e konfidencialitetit;
 - Ky informacion ka qenë për përdorim publik në kohën e zbulimit; ose
 - Është zhvilluar në mënyrë të pavarur, pa akses në Informacionin Konfidencial të Palës tjetër.
 - Një informacion i tillë është i detyrueshëm për tu nxjerre sipas ligjit.
- 35.3 Koncesionari mund t'i zbulojë Informacionin Konfidencial të Autoritetit vetëm Personelit të Koncesionarit që është i përfshirë drejtpërdrejt në ofrimin e Shërbimeve dhe që ka nevojë të dije informacionin dhe do të sigurojë që ky Personeli i Koncesionarit të ndërgjegjësohet dhe të përmbushë këto detyrime në lidhje me konfidencialitetin.
- 35.4 Koncesionari nuk do të përdorë Informacion Konfidencial të Autoritetit dhe do të sigurojë që Personeli i Koncesionarit të mos përdorë Informacion Konfidencial të Autoritetit, të marrë për qëllime të ndryshme nga ato të kësaj Kontrate.
- 35.5 Koncesionari ndërmerr (perverse kur mund të kërkohej nga ligji ose me qëllim udhëzimin e konsulentëve profesioniste në lidhje me këtë Kontratë) të mos:
- Zbulojë ose lejojë zbulimin e ndonjë hollësie të kësaj Kontrate për median e lajmeve ose ndonjë pale të treta përveç Nënkontraktoreve;
 - Përdorë emrin e Autoritetit dhe ose marken në ndonjë promovim ose marketing ose shpallje të urdhrave, pa miratimin paraprak me shkrim të Autoritetit.

35.6 Autoriteti ka te drejte te përhapit Informacionin Konfidencial te Koncesionarit:

- Ndaj cilitdo enti qeveritar te cilët do te kenë te drejte t'ia japin me tej Informacionin Konfidencial institucioneve te tjera shtetërore, duke siguruar qe informacioni te mbetet konfidencial dhe te mos i zbulohet një pale te trete qe nuk është pjese e departamentit qeveritar ose e një autoriteti.
- Mbi bazën e "nevojës për njohuri" nga konsulenti, kontraktori ose ndonjë person tjetër te angazhuar nga Autoriteti me kusht qe një person i tille te bjere dakord qe ta ruaje këtë informacion si konfidencial;
- Mbi bazën e "nevojës për njohuri", për qellim te shqyrtimit dhe vërtetimit të llogarive te koncesionarit.

35.7 Autoriteti do te beje te gjitha përpjekjet e arsyeshme per te siguruar qe çdo institucion shtetëror, punonjës apo palë e trete ose pale e huaj te cilës i jepet Informacionin Konfidencial i Koncesionarit si me lart te ndërgjegjësohet për detyrimet ligjore te konfidencialitetit te Autoritetit.

36. FORCA MADHORE

36.1 "Rast i Forcës Madhore" do te thotë ç'do rrethane apo ngjarje qe ne mënyrë objektive është tej parashikimit dhe kontrollit absolut, te drejtpërdrejtë ose te tërthorte, te Palës se cënuar ("Pala e Cenuar") dhe shkakton pamundësi te plote ose te pjesshme te Palës se Cenuar për te përmbushur ndonjë apo te gjitha detyrimet e saj sipas kësaj Kontrate, por vetëm nëse dhe ne masën qe:

- kjo rrethane, pavarësisht ushtrimit te kujdesit te arsyeshëm, nuk mund te parandalohet apo nuk ishte e mundur te parandalohet, shmangej ose mënjanohej nga Pala e Cenuar;
- Pala e Cenuar ka marre te gjitha masat e arsyeshme paraprake, kujdesin e duhur dhe masat e arsyeshme alternative ne mënyrë qe te shmangte pasoja ne aftësinë e Palës se Cenuar për te përmbushur detyrimet e saj sipas kësaj Kontrate dhe për te zbutur pasojat e saj;
- ngjarja nuk është, ose nuk ka qene pasoje e drejtpërdrejtë ose e tërthortë e shkeljes nga Pala e Cenuar te ndonjë prej detyrimeve te saj sipas kësaj Kontrate, dhe
- Pala e Cenuar t'i ketë dhënë njoftim Palës tjetër ("Pala e Pacenuar").

36.2 Rastet e Forcës Madhore përfshijnë rrethanat e mëposhtme, por pa u kufizuar vetëm ne to, me kusht qe ato te plotësojnë kriteret e shprehura ne përkufizimin e Rastit te Forcës Madhore me sipër:

- veprimet e luftës, pushtimi ose akti i një armiku te jashtëm, ose aktet e terrorizmit, bllokadat, embargot, racionimet;
- aktet e rebelimeve, kryengritjet, trazirat civile, grevat e natyrës politike, aktet ose fushatat e terrorizimit;
- rrufeja, zjarr, tërmeti, stuhia, cikloni, tajfuni, tornado ose ndonjë fatkeqësi tjetër natyrore;
- epidemitë ose murtaja; dhe
- çdo akt sabotimi, grevat ose veprimtaritë e punës për te imponuar ose për të ngadalësuar punën

36.3 Pala e Cenuar do te përjashtohet nga përmbushja e detyrimeve dhe nuk do te konsiderohet ne mos permbushje te Kontratës për aq kohe dhe ne atë mase sa zgjat pamundësia per e përmbushur detyrimet. Njëkohësisht, Periudha e Koncesionit do te shtyhet automatikisht për aq sa do te zgjasë Ngjarja e Forcës Madhore.

36.4 Palët ne këtë Kontrate pas përfundimit te forcës madhore dhe brenda një afati 3 mujor pasues, do te sigurojnë përmbushjen e detyrimeve sipas kësaj kontrate apo rivënien ne jete te shërbimeve, duke mbajtur secila pale detyrimet dhe shpenzimet përkatëse sipas kësaj Kontrate.

37. NEGOCIATAT DHE AMENDAMENTET

37.1 Ndryshimet në kontratë bëhen nga Autoriteti dhe Koncesionari .

37.2 Ndryshimet në kontratë mund të bëhen me iniciativën e të dyja palëve kontraktuese veçanërisht në rastet e mëposhtme:

- a) kur rrezikohet siguria kombëtare dhe mbrojtja e vendit, rrezikohet mjedisi, natyra dhe shëndeti i njerëzve;
- b) kur humbet objekti i kontratës ose kur ekziston një pamundësi objektive për përdorimin e tij, në rastin e forcës madhore;
- c) gjatë ndryshimit të kuadrit ligjor;
- d) në raste të tjera që çojnë në ndryshimin e situatës reale ose ligjore për përdorimin e objektit apo ofrimin e shërbimeve, ose në realizimin e kontratës.

- 37.3 Ndryshimet e kushteve thelbësore të kontratës që nuk parashikohen në dokumentacionin e tenderit dhe/ose në vetë kontratën kërkojnë zbatimin e një procedure të re të dhënies së kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat.
- 37.4 Pa shkelur parashikimet e Ligjit nr. 125/2013 “Per koncesionet dhe partneritetin publik privat” termi “kushtet thelbësore” u referohen në veçanti kushteve të cilat, nëse do të kishin qenë të përfshira në njoftimin fillestar të kontratës ose në dokumentacionin e tenderit, do të kishin bërë të mundur që ofertuesit të dorëzonin një ofertë në thelb të ndryshme, si dhe nëse ndryshimet do të kishin tejkaluar objektin e kontratës në atë masë që këto ndryshime do të përfshinin shërbimet që nuk mbulohen fillimisht.
- 37.5 Autoriteti kërkon një miratim paraprak nga Ministria e Financave për të gjitha ndryshimet e planifikuara, të cilat ndikojnë ose krijojnë riskun e ndikimit direkt ose indirekt në buxhetin e shtetit ose në buxhetin e organeve vendore apo të cilat mund të ndryshojnë në ndonjë mënyrë mbështetjen financiare siç përcaktohet nga ky ligj.
- 37.6 Autoriteti njofton jo më vonë se 20 ditë Ministrinë e Financave për ndryshimet e bëra në kontratë në përputhje me këtë nen.
- 37.7 Nëse pas datës së nënshkrimit të kësaj Kontrate, miratohet dhe hyn në fuqi çfarëdo lloji ligji, akti apo procedure që ka fuqinë e ligjit në Republikën e Shqipërisë dhe ndikon termat dhe kushtet e kësaj Kontrate në dem të Koncesionarit, termat dhe kushtet e kësaj Kontrate do të përshtaten dhe/ose rregullohen në masën që Koncesionari është prekur për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të Koncesionarit në të njëjtat kushte siç ishin para ndryshimeve ligjore të lartpërmendura.

38. NDËRPRERJA

Autoriteti mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse Koncesionari falimenton ose bëhet i paafhtë të paguajë. Autoriteti duhet t'i japi Koncesionarit njoftim me shkrim për ndërprerjen.

39. DËMSHPËRBLIMI

- 39.1 Koncesionari do të jetë përgjegjës për shpërblimin e demit ndaj Autoriteti dhe/ose çdo Enti Shtetëror që vjen si rezultat ose pasojë e mos përmbushjes nga ana e tij.
- 39.2 Autoriteti dhe/ose çdo Enti Shtetëror do të jetë përgjegjës për shpërblimin e demit ndaj Koncesionarit që vjen si rezultat ose pasojë e mos përmbushjes nga ana e tij.
- 39.3 Shpërblimi i demit mund të kërkojë sipas rastit nga Koncesionari ose Autoriteti, pa cenuar ushtrimin e të drejtave të tjera në këtë Kontratë.
- 39.4 Në të gjitha rastet pala që vendos ose pretendon të drejtën për t'iu shpërblyer demit në përputhje me këtë Kontratë do të ketë detyrimin të marrë të gjitha masat për të pakesuar efektet e demit të ndodhur, duke marrë parasysh se ajo mund ta bejë këtë pa shkaktuar shpenzime të paarsyeshme.

40. TRANSFERIMI I TË DREJTAVE

- 40.1 Në përputhje me dispozitat e këtij neni, me pëlqimin paraprak me shkrim nga Autoriteti, kontrata e koncesionit/partneritetit publik privat mund të transferohet të një personi të tretë që përmbush kërkesat e përshtatshmërisë, të përcaktuara në dokumentacionin e tenderit, në bazë të cilit kontrata ishte dhënë fillimisht, përveç se

nëse këto kërkesa u referohen kushteve që nuk janë më të nevojshme për përmbushjen e kontratës, për shkak të faktit se këto detyrime dhe kërkesa të përmendura janë tashmë duke u konsumuar ose duke u realizuar nga Konçesionari /partneri privat i mëparshëm. (kushte të transferimit të parashikuara në nenin 20 të “kushtet e përgjithshme të kontratës” aneks i dokumenteve të gares)

- 40.2 Transferimi i kontratës së koncesionit mund të behet vetëm nëse nuk prish cilësinë dhe nuk përkeqëson vazhdimësinë e realizimit dhe të përmbushjes së kontratës.
- 40.3 Kur Konçesionari është një subjekt për qëllime të veçanta, atëherë ndryshimi i të drejtave të pronësisë apo i menaxhimit të Subjektit për qëllime të veçanta (SPV), si rezultat i transferimit të kapitaleve ose të aksioneve të biznesit, nuk mund të zbatohet pa miratimin e Autoritetit dhe të Ministrisë së Financave, përveç nëse ky është një rezultat i tregimit të rregullt të aksioneve në një treg të rregulluar të kapitalit.
- 40.4 Autoriteti kërkon një miratim paraprak nga Ministria e Financave për të gjitha transferimet e planifikuara të kontratës, të cilat ndikojnë ose krijojnë rrezikun e ndikimit në ndonjë mënyrë në buxhetin e shtetit ose në buxhetin e njësisë të qeverisjes vendore, ose të cilat mund të ndryshojnë në ndonjë mënyrë mbështetjen financiare, siç përcaktohet nga ligji.

41. VONESAT NË ZBATIM – DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

- 41.1 Nëse, në çdo kohë, Konçesionari është në gjendje të parashikojë se ai nuk do të (apo se ka pak të ngjarë që të) arrijë cilindo nga afatet e parashikuara në projektin që Konçesionari ka paraqitur për pjesëmarrje në ofertën e paraqitur, ai do të njoftojë menjëherë Autoritetin mbi faktin e Vonesës duke bërë një përmbledhje të shpjegimeve përkatëse.
- 41.2 Konçesionari, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në çdo rast jo më vonë se sa 10 ditë pune pas njoftimit fillestar sipas Nenit 42.1, do t'i japë Autoritetit hollësi të plota me shkrim për:
 - (i) Arsyet e Vonesës;
 - (ii) Pasojat e Vonesës;
 - (iii) Nëse Konçesionari pretendon se Vonesa vjen për shkak të Autoritetit, arsyen pse e paraqet atë pretendim.
- 41.3 Në rast se vonesa vjen si pasoje e mos përmbushjes së detyrimeve të Autoritetit, Konçesionari do të ndërmarrë të gjitha hapat e arsyeshme për të shmangur apo zvogëluar pasojat e Vonesës, aq sa mund të jete e mundur dhe e përballueshme financiarisht, me kusht që kosto të tilla shtesë të pësuara nga Konçesionari për shkak të Pazotësisë së Autoritetit t'i jenë njoftuar paraprakisht me shkrim këtij të fundit të paktën 20 (njëzet) ditë përpara kryerjes së shpenzimeve të tilla. Konçesionari është i detyruar të respektojë këtë procedurë, me përjashtim të një situatë emergjente kur ai për të shmangur efektet negative të vonesës nuk ka kohë të mjaftueshme për të njoftuar Autoritetin. Në çdo rast Konçesionari do të rimbursohet nga Autoriteti për të gjitha shpenzimet e arsyeshme dhe të nevojshme shtese të kryera si rezultat i një situatë të tillë, brenda një periudhe kohore jo më shumë se 20 (njëzet) ditë pune nga çelja e fondeve buxhetore të Autoritetit për vitin pasardhës, nëse detyrimi për rimbursim lind brenda 6 (gjashtë) mujorit të parë të një viti kalendarik. Nëse ky detyrim lind brenda 6 (gjashtë) mujorit të dytë të një viti kalendarik atëherë shpenzimet do të paguhet brenda 20 ditëve nga mbarimi i një periudhe prej 19 (nëntëmbëdhjetë) muajsh që fillon nga momenti i lindjes dhe njoftimit të detyrimit.
- 41.4 Çfarëdo konflikti mes palëve, si rrjedhojë e vonesave do të zgjidhet përmes procedurës për zgjidhjen e mos marrëveshjeve. Gjatë kohës së zgjidhjes së konfliktit të dy Palë do të vazhdojnë të punojnë për të zgjidhur shkaqet apo për të zvogëluar pasojat e Vonesës.
- 41.5 Nëse është e mundur Konçesionari do të paraqesë një projekt të planit të korrigjimit, në rast se nuk është në gjendje të arrijë afatet e parashikuara sipas planeve vjetore të deklaruara prej tij. Projekt-Plani i Korrigjimit do të identifikojë ceshtjet që rrjedhin nga vonesa dhe hapat që Konçesionari propozon që të ndërmerren për të arritur afatet në përputhje me këtë Kontratë.
- 41.6 Projekt-Plani i Korrigjimit do të paraqitet Autoritetit për miratim sa më shpejt që të jete e mundur dhe në çdo rast jo më vonë se 45 ditë pune (apo një periudhe kohore tjetër) të tilla që Autoriteti mund të lejojë dhe të njoftojë Konçesionarin me shkrim pas njoftimit fillestar. Autoriteti nuk do të refuzojë miratimin e tij për një Projekt-Plan Korrigjimi në mënyrë

te paarsyeshme. Autoriteti do te shprehet mbi propozimin e Koncesionarit brenda 15 ditëve pune nga paraqitja e kërkesës, në rast të kundërt propozimi konsiderohet i miratuar nga ana e Autoritetit.

41.7 Konçesionari do te veproje ne përputhje me Planin e tij te Korrigjimit.

41.8 Palet bien dakord qe marrja nga Konçesionari , e te gjitha licensave, autorizimeve dhe lejeve te kërkuara per ekzekutimin e projektit, është thelbësore per zbatimin e kesaj kontrate. Ne rast vonese ne marrjen e licencave, autorizimeve dhe lejeve te tilla, te shkaktuara nga subjekte qe i atribuohen Autoritetit si rezultat i tejkallimit te afateve ligjore per dhënien e tyre, Autoriteti ose Enti Shtetëror nuk do te konsiderohet ne vonese deri ne nje periudhe 20 (njëzet) Dite Pune nga kalimi i afatit ligjor per dhënien e tyre.

42. LLOGARITJA E AFATEVE

Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim kur parashikohet ndryshe.

43. ZGJIDHJA E KONTRATËS

43.1 Autoriteti, në rast se nuk është parashikuar në këtë Kontrate, i jepet e drejta për të zgjidhur këtë Kontrate kur:

- a) Konçesionari është ne shkelje te elementeve thelbësore te Projektit Teknik.
- b) Konçesionari transferon të drejtat dhe detyrimet e marra përsipër me këtë Kontrate, pa miratim të Autoritetit
- c) Konçesionari me veprimet ose mosveprimet e tij të kryera me dashje ose nga pakujdesia, shkakton shkelje serioze te Kontratës

43.2 Zgjidhja e Kontrates sipas parashikimit më sipër, mund te kërkohe nga Autoriteti vetëm pas kryerjes se verifikimeve te përshtatshme dhe ne baze te provave shkresore dhe pas ballafaqimit te drejtpërdrejt me Konçesionarin .

43.3 Nëse kontrata zgjidhet nga Autoriteti për arsye të “Forcës Madhore”, Konçesionari ka të drejtë të kërkojë nga Autoriteti pagesen e e plotë të kredive per Sherbimet e kyera nga Konçesionari dhe të pashlyera nga Autoriteti deri në momentin e zgjidhjes.

43.5 Nëse Kontrata zgjidhet pa asnjë shkak nga Autoriteti, Konçesionari ka të drejtën të kërkojë nga Autoriteti kompensimin e plotë të vlerës së investimit te kryer prej tij si dhe gjithë demin e shkaktuar. Autoriteti detyrohet t'i paguaje Konçesionarit një kusht penal te barabarte me vlerën e investimit te realizuar, përveç demit te shkaktuar.

44. PASOJAT TË TJERA TË PËRFUNDIMIT

44.1 Me njoftimin për përfundim të parakohshëm të Kontratës, Palët janë të detyruara të nisin procedurën e dorëzimit të të aseteve të marra në dorëzim nga Konçesionari, sipas kësaj Kontrate.

44.2 Mbarimi i Periudhës së Konçesionit, apo përfundimi i parakohshëm i kësaj Kontrate (sido që të ndodhe ai), nuk duhet të cenoje të drejtat apo ligjshmërinë e çdonjëres prej palëve, në këtë Kontrate e cila në mënyre të qarte apo të nënkuptuar, ka si qëllim të veproje edhe pas përfundimit apo mbarimit të saj (kesaj Kontrate) mbi parashikimet e dispozitave të nenit 35 (Konfidencialiteti), 40 (Dëmshpërblimi), 50 (Kontrata si një e tere) dhe 52 (Ligji rregullues).

45. TRANSFERIMI I ASETEVE

45.1 Me mbarimin e Kontratës, Koncesionari do të kryejë çdo veprim të nevojshëm për dorëzimin tek Autoriteti, të aseteve të marra në dorëzim nga ai, ato të realizuara nga Koncesionari gjatë periudhës së koncesionit si dhe çdo titull mbi to, të zhveshura nga çdo lloj detyrimi, barre apo hipoteke.

45.2 Procesi i dorëzimit do të fillohet të paktën 6 (gjashtë) muaj përpara datës së mbarimit të Periudhës së Koncesionit me një inspektim të përbashkët të Autoritetit dhe Koncesionarit.

45.3 Koncesionari, duhet të transferojë pa kundërshpërblim në favor të Autoritetit të gjithë teknologjinë, instrumentet kirurgjikale, aksesore dhe logjistike siç janë parashikuar në Aneksin 5 bashkëngjitur kësaj Kontrate.

46. PARANDALIMI I KORRUPSIONIT

Koncesionari nuk do të ofrojë apo të bie dakord të japë cilido person që punon apo është angazhuar nga Autoriteti apo cilido organ tjetër i qeverisë shqiptare çfarëdo dhurate apo gjëje të ngjashme e cila mund të shërbejë si shtysë apo si një shpërblim për çfarëdo veprimi apo mosveprimi në lidhje me këtë Kontratë, ose me çdo Kontratë tjetër ndërmjet Koncesionarit dhe Autoritetit ose cilido organ të qeverisë shqiptare, duke përfshirë këtu dhënien e kësaj kontratë ndaj Koncesionarit dhe cilëso nga të drejtat dhe detyrimet që përmbahen në të; dhe as nuk do të futet në këtë Kontratë nëse ka njohuri se, në lidhje me të, çfarëdo shume në para është paguar apo do të paguhet cilido person që punon për apo është i përfshirë nga Autoriteti apo cilido organ tjetër i qeverisë shqiptare apo për Koncesionarit apo se një Kontratë është e arritur për këtë qëllim, përveçse kur hollësi të një kontratë të tillë janë bërë të njohura me shkrim për Autoriteti përpara zbatimit të kësaj Kontrate.

47. PUBLICITETI

Koncesionari nuk do të bëjë asnjë deklaratë për shtyp apo ta publikojë këtë Kontratë apo përmbajtjen e saj në asnjë mënyrë pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit, pëlqimi i të cilit nuk do të refuzohet apo vonohet paarsyeshmërisht.

48. PAVLEFSHMËRIA E PJESHME

Nëse cilado nga dispozitat e kësaj Kontrate vlerësohet si e pavlefshme, e paligjshme apo e pazbatueshme për çfarëdo arsye dhe nga cilido juridiksion kompetent, një dispozitë e tillë do të ndahet pa sjellë pasoja për dispozitat që mbeten. Nëse një dispozitë e kësaj Kontrate që është themelore për përmbushjen e qëllimit të kësaj Kontrate gjykohet se është e pavlefshme në çfarëdo shtrirje, Koncesionari dhe Autoriteti do të fillojnë menjëherë negociatat në mirëbesim për ta rregulluar këtë pavlefshmëri.

49. MARRËVESHJA SI NJË E TËRË

49.1 Kjo Kontratë së bashku me Dokumentet Standarde të Koncesionit dhe dokumentet të cilave i bëhet referim në të, përbën kontratën si një e tërë dhe mirëkuptimin e Palëve në lidhje me çështjet e trajtuara në të dhe sundon mbi, zhvlerëson dhe shfuqizon çdo Kontratë apo Marrëveshje të mëparshme ndërmjet Palëve në lidhje me çështje të tilla pavarësisht nga termat e cilido rregullim apo cilëso Kontrate të mëparshme që kanë shprehur se nuk do të përfundojnë.

49.2 Secila nga palët një dhe bie dakord se me nënshkrimin e kësaj Kontrate dhe në dokumentet e referuar në të, ajo nuk mbështetet në asnjë Kontratë apo marrëveshje të mëparshme dhe si rrjedhim nuk do të përfitojë asnjë dëmshpërblim në lidhje me këtë, çfarëdo deklaratë, përfaqësimi, garancie apo detyrimi të marrë përsipër (qoftë e bërë nga neglizhenca apo pa faj) të ndryshme nga sa është e thënë në mënyrë të shprehur në këtë Kontratë. Asgjë në këtë Nen nuk do të veprojë për të mënjnauar apo përjashtuar çdo lloj përgjegjësie me bazë mashtrimin.

50. GJUHA DHE KOPJET

Kjo Kontratë do të hartohet dhe nënshkruhet në gjuhën shqipe në 7 (shtatë) kopje origjinale.

51. LIGJI RREGULLUES DHE JURISDIKSIONI

51.1. Kjo marrëveshje do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.

51.2. Çdo kundërshti, mosmarrëveshje apo ankesë midis Palëve kontraktuese që lind pse ka lidhje me zbatimin dhe interpretimin e kësaj Kontrate Koncesioni, do të zgjidhet me mirëkuptim midis tyre duke u bazuar në vullnetin e mirë.

Në rast se zgjidhja me mirëkuptim midis tyre duke u bazuar në vullnetin e mirë dështon, atëherë mosmarrëveshja mes Palëve do të zgjidhet përmes Arbitrazhit Ndërkombëtar, referuar rregullave të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë Paris (ICC Rules).

Vendi i Arbitrazhit do të jetë France - Paris, ndërsa gjuha e Arbitrazhit do të jetë gjuha Angleze.

Në rast mosmarrëveshje, në varësi të vlerës së mosmarrëveshjes Palët do të bien dakord në lidhje me numrin e Arbitrave. Në rast se do të jemi para rastit që mosmarrëveshja do të gjykohet nga tre Arbitra, atëherë secila nga palët ka të drejtë të zgjedhë nga një Arbitër dhe së bashku do të bien dakord me Krye Arbitrin, i cili do të ketë shtetësitë ndryshëm nga Palët në konflikt. Në rast se palët nuk do të arrijnë të bien dakord, atëherë Krye Arbitri do të zgjidhet nga Sekretariati i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë Paris duke iu referuar në çdo rast rregullave të ICC në fuqi në momentin që kjo Kontratë bëhet efektive.

52. NJOFTIMET

Njoftimet e dhëna sipas apo në lidhje me këtë Kontratë do të jenë me shkrim të nënshkruara nga apo në emër të Palës që bënë njoftimin dhe do të dërgohen me postë të regjistruar ose me faks në adresën dhe në vëmendje të Palës përkatëse apo në atë adresë që Pala mund të ketë njoftuar me shkrim. Njoftimet mund të bëhen edhe me postë elektronike në adresën elektronike të përcaktuar. Çdo kërkesë për ndryshim do të jetë me shkrim dhe e nënshkruar nga Palët.

Palët bien dakord dhe pranojnë sa më sipër është deklaruar, duke nënshkruar më poshtë.

Për **MINISTRINË E SHËNDETËSISË SË REPUBLIKËS SË SHqipërisë**

Z. ILIR BEQJA

Ministër

Për **SANISERVICE Sh.p.k.**

Z. ADMIR DACA

Administrator